



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 164 Akti

Nr. 263 Vendimi
Tiranë, më 17.6.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessing, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në datën 3.3.2020 në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Nure Dreni**, gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shpresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore, si dhe pasi shqyrtoi çështjen mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

1. Znj. Nure Dreni, gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, shortuar si subjekt rivlerësimi me shortin e hedhur në datën 5.11.2018, me trupin gjykues nr. 3, në përputhje me Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” me trupin gjykues nga komisionerët: Suela Zhegu, Olsi Komici dhe Xhensila Pine (relatore).

2. Me vendimin nr. 1, datë 22.11.2018, trupi gjykues nr. 3 vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe të caktojë me mirëkuptim kryesuesin z. Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mosqenien në konflikt interesi.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshillit i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

4. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave për këtë procedurë rivlerësimi.

5. Në datën 13.11.2019, trupi gjykues vendosi bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi provat për këtë kriter, kishin arritur nivelin e provueshmërisë.

6. Për sa më sipër, trupi gjykues, me e-mail-in e datës 14.1.2019: (i) njoftoi subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (ii) njoftoi subjektin e rivlerësimit me të drejtën për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) njoftoi subjektin e rivlerësimit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit; si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

7. Në datën 18.11.2019 subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, dërgoi me anë të postës elektronike kërkesën për përfshirjen edhe të dy komponentëve të tjerë, atë të figurës dhe të vlerësimit profesional, për të si subjekt rivlerësimi, si dhe për kohë shtesë në dispozicion për sjelljen e shpjegimeve e provave në përgjigje të barrës së provës.

8. Pas njohjes me kërkesën e sjellë nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vendosi dhe informoi subjektin për mos pranimin deri në këtë fazë të kërkesës për përfshirjen edhe të komponentëve të tjerë, atë të figurës dhe të vlerësimit profesional bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vendosi dhe informoi subjektin për pranimin e kërkesës për shtyrje afati, për paraqitjen e provave dhe shpjegimeve, duke i caktuar si afat të ri, deri në datën 1.12.2019.

9. Subjekti i rivlerësimit, brenda afatit të përcaktuar nga trupi gjykues, paraqiti provat dhe shpjegimet e saj. Trupi gjykues, pasi administroi dhe analizoi dokumentacionin e dorëzuar mbi rezultatet e hetimit vetëm për kriterin e pasurisë, dhe shpjegimet e depozituara nga subjekti vendosi në datën 10.12.2019 rihapjen e hetimit shtesë për kriterin e pasurisë, si dhe hapjen e hetimit për vlerësimin e figurës dhe vlerësimin profesional për subjektin e rivlerësimit.

10. Subjekti i rivlerësimit u njoftua për këtë vendim nëpërmjet komunikimit elektronik.

11. Pas hetimit kryesisht shtesë të pasurisë, dhe hetimit kryesisht të figurës dhe vlerësimit profesional, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit në datën 7.2.2020, me të drejtën të njihet me dosjen e hetimit shtesë të procedurës së rivlerësimit për kriterin e pasurisë, si dhe me dosjen e hetimit për kriteret e vlerësimit profesional dhe të figurës, duke i njoftuar të drejtën për t’u pajisur me kopje të tyre, në përputhje me nenet 45- 47, dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurës Administrative, si dhe për sjelljen e shpjegimeve dhe provave deri më 18.2.2020.

11.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, brenda afatit të përcaktuar, paraqiti provat dhe shpjegimet e saj, për hetimin shtesë administrativ për kriterin e pasurisë, për gjetjet dhe rezultatet në lidhje me kriterin profesional, si dhe për denoncimet e publikut.

12. Trupi gjykues, pasi administroi dhe analizoi provat dhe shpjegimet e depozituara me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë Znj. Nure Dreni, në seancën dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

13. Përmes postës elektronike në datën 26.2.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 3.3.2020, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Në datën 3.3.2020, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të vëzhgueses ndërkombëtare. Në seancë, subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, e cila u paraqit personalisht edhe me përfaqësues ligjor, u shpreh në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti kundërshtoi rezultatet e hetimit nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

15. Seanca e zhvilluar u ndërpre për të vijuar në seancën e shpalljes së vendimit në datën 18.3.2020, ora 9:30, në po të njëjtën sallë në Pallatin e Koncerteve.

16. Në kuadër të masave mbrojtëse nga COVID-19, nga data 13.3.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pezulloi afatet për të gjitha vendimet dhe seancat dëgjimore për subjektet e rivlerësimit, ndaj shpallja e këtij vendimi i shty nga data 18.3.2020 për në datën 17.6.2020.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, znj. Nure Dreni, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë e gatshme për bashkëpunim gjatë hetimit, dhe zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

18. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

19. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku ka rezultuar, si vijon:

20. Autoveturë tip “C c *”, prodhim i vitit 2010, me vlerë 13.800 euro. Burimi i krijimit i deklaruar në deklaratën *Vetting*: kredi në shoqërinë “Tirana Leasing” sh.a., sipas kontratës nr. ***, datë 16.2.2010; të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti (S. D), si rrjedhojë e vendimit gjyqësor

nr. ***, datë 17.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ekzekutuar nga Zyra e Përmbarimit në datën 14.5.2010, në llogarinë bankare nr. **** EC në “Tirana Bank”.

21. Automjeti i deklaruar në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 rezulton që të jetë deklaruar edhe në deklaratën periodike të vitit 2010.

22. Në deklaratën periodike të vitit 2010 është deklaruar: blerje automjeti “C c *” me kredi 50 % të vlerës, sipas kontratës nr. ***, datë 16.2.2010 të redaktuar nga notere E. K nga të ardhurat e këtij viti, në vlerën 6.900 euro.

23. Rezulton se burimi i të ardhurave në deklaratën *Vetting* është i ndryshëm nga burimi i të ardhurave në deklaratën periodike të vitit 2010. Deklarimi në deklaratën *Vetting* për burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për pagesën e shumës 6.900 euro në vitin 2010, duket se nuk përputhet me faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, pasi ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 17.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është kryer vetëm në datën 14.5.2010, pas blerjes së automjetit.

24. Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë financiare për blerjen e automjetit. Për periudhën 1.1.2010 – 9.2.2010, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë krijuar të ardhura nga pagat në shumën 230.846 lekë, nga të cilat rezultojnë të tërhequra nga banka 182.000 lekë. Të ardhurat e gjeneruara nga investimi në bono thesari në shumën 147.131 lekë janë tërhequr në datën 12.2.2010 në Bankën së Shqipërisë dhe nuk kanë shërbyer si burim në momentin e kryerjes së pagesës prej 6.900 euro.

25. Nga analiza financiarë e kryer rezultoi se subjekti sipas burimit të deklaruar ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 773.719 lekë për pagesën e këstit të parë të automjetit.

26. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar ë kundërtën, për sa më poshtë vijon:

- Mospërputhje deklarimi, për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie të luajtshme në pronësi të subjektit, midis deklaratës *Vetting* dhe deklarimit periodik vjetor të vitit 2010, pasi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti ka deklaruar të ardhurat e vitit, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka përcaktuar si burim të ardhura të përfituara nga bashkëshorti (S. D), si rrjedhojë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 17.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Mospërputhje deklarimi për sa i përket vlerës së kësaj pasurie midis deklarimit periodik të vitit 2010 në të cilin ka deklaruar si çmim blerjeje vetëm 6.900 euro, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklarohet vlera prej 13.800 euro.
- Mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -773,719 lekë për pagesën e këstit të parë në shumën 6.900 euro.
- Si burim krijimi për blerjen e automjetit, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar, një burim i cili nuk ishte krijuar ende, pasi shuma nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, datë 14.5.2010, nuk mund të shërbente për krijimin e kësaj pasurie.

26.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

Subjekti në prapësimet e tij shprehet: “Në momentin e blerjes (datë 9.2.2010) janë tërhequr likuiditet nga gjendja cash që disponoja në datën 31.12.2009 dhe të cilat pranohen nga Ju se ekzistojnë. Në momentin që është ekzekutuar vendimi gjyqësor nr. ***, datë 17.7.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shuma e vënë në dispozicion që u bë e aksesueshme për tu përdor, siç kemi deklaruar pjesërisht gjatë vitit 2010 zëvendësoi gjendjen cash (e cila është deklaruar në deklaratën periodike

vjetore të vitit 2009), pasi kjo gjendje u ruajt e njëjtë edhe gjatë vitit 2010, nuk ka pasur ndryshime (shtesa dhe pakësim).

... duke i konsideruar lapsuse apo pakujdesi burimet e shënuara në deklaratën “Vetting”, pasi në fund të fundit brenda vitit pagesat në cash japin të njëjtin rezultat. Në këto kushte, kërkoj nga trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që ky konstatim për pamundësi financiare të rishikohet dhe të konkludohet në konstatim pozitiv nga Ju, duke pranuar se unë subjekti i rivlerësimit kam pasur mundësi financiare në momentin e pagesës së këstit të parë të pasurisë autoveturë ‘C c *’ në shumën 6.900 euro, dhe se kam pasur burim të ligjshëm të ardhurash për këtë shumë”.

27. Komisioni, pasi vlerësoi provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arriti në përfundimin se subjekti ka pasur mundësi financiare në momentin e pagesës së këstit të parë të pasurisë autoveturë “C c *” në shumën 6.900 euro. Subjekti arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri të paluajtshme në pronësi, por subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, **ka kryer deklaram të pasaktë të burimit të krijimit të pasurisë së luajtshme (automjet) në deklaratën e pasurisë Vetting.**

Analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 2003 – 2016

28. Gjatë hetimit administrativ është kryer një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare të deklaruara nga subjekti, duke i krahasuar ato me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore.

Komisioni analizoi mundësinë financiare për periudhën 2003 – 2016, sipas metodikës si vijon:

Të ardhurat

28.1 Në këtë kategori janë përfshirë të gjitha të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të tjerë të familjes nga pagat, të ardhurat nga bursa, të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 17.7.2009, interesat e përfituara nga investimi në bono thesari, interesat bankare të depozitave, të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të ardhurat e përfituara nga kontratat e sigurimit shëndetësor.

28.2 Të ardhurat e deklaruara nga subjekti janë vërtetuar me dokumentacionin nga institucionet në të cilët kanë qenë të punësuar: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore; banka të nivelit të dytë; si dhe kontrata të ndryshme. Për të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit janë marrë në analizë vlerat referuar vërtetimeve.

28.3 Për të ardhurat nga bursa janë marrë në analizë vlerat referuar shumave të përfituara në llogarinë në “Credins Bank” nga Bashkia Tiranë.

28.4 Për të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 17.7.2009, është marrë në analizë shuma e kaluar në llogarinë bankare të subjektit në datën 14.5.2010.

28.5 Për të ardhurat në formën e interesave të përfituara nga investimi në bono thesari janë marrë në analizë të dhënat sipas nxjerrjes së llogarisë bankare në BKT, si dhe nxjerrja e llogarisë nga Departamenti i Operacioneve Monetare nga Banka e Shqipërisë.

28.6 Për të ardhurat në formën e interesave bankare të depozitave janë marrë në analizë vlerat sipas nxjerrjes së llogarisë bankare.

28.7 Për të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme janë marrë në analizë vlerat sipas kontratave të shitblerjeve.

Detyrimet

28.8 Në këtë rubrikë janë pasqyruar shumat e marra hua referuar kontratave të huas lidhur me bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare jo bankare dhe personat fizikë.

Shpenzimet

28.9 Në këtë kategori janë hedhur të gjitha shpenzimet e deklaruara nga subjekti si: shpenzime shkollimi; shpenzime pushimesh; shpenzime qiraje; si dhe shpenzime mobilimi etj.

28.10 Shpenzimet jetike për anëtarët që kanë jetuar në Shqipëri janë marrë referuar shkresës së ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 4.3.2019, drejtuar Komisionit. Për vitin 2007 konsumi për frymë është marrë sa viti 2006, pra, në vlerën 136.620 lekë.

28.11 Për shpenzimet e udhëtimit janë marrë në analizë referuar të dhënave nga sistemi *TIMS*, informacionit dhënë nga subjekti i rivlerësimit për vendin dhe kohën e qëndrimit si dhe sipas Standardit të Komisionit.

28.12 Në lidhje me deklaratimet e udhëtimeve jashtë territorit të Shqipërisë dhe shpenzimet për udhëtimin për akomodimin, si dhe shpenzime të tjera janë bazuar në të dhënat e siguruar nga sistemi *TIMS*. dhe dokumentacionit justifikues ligjor te depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

28.13 Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal+interes) i referohen pagesave të kësteve të kredisë sipas nxjerrjes së llogarive bankare nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga "Tirana Leasing".

28.14 Shpenzimet e mobilimit janë marrë në analizën financiare, referuar deklaratimit të subjektit sipas pyetësorit nr. 3

Për shpenzimet e shkollimit të vajzave A dhe G. D në Mbretërinë e Bashkuar

28.15 Për periudhën 2011 – subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, ka deklaruar vlerën 13.380 GBP, ndërsa në pyetësorin e parë ka deklaruar shpenzime studimi në Mbretërinë e Bashkuar: vlerën 10.800 GBP – tarifë studimi; vlerën 2.580 GBP – shpenzime qiraje; vlerën 2.000 GBP – shpenzime qëndrimi, pra, total vlerën 15.380 GBP.

28.16 Për periudhën 2012 – subjekti në deklaratën periodike vjetore të viti 2012 ka deklaruar si shpenzime studimi në Mbretërinë e Bashkuar vlerën prej 11.350 GBP, ndërsa në pyetësorin e parë ka deklaruar si shpenzime: vlerën 6.950 GBP – tarifë studimi; vlerën 4.125 GBP – shpenzime qiraje; vlerën 2.700 GBP – shpenzime qëndrimi, pra, total vlerën 13.775 GBP.

28.17 Për periudhën 2013 – subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 ka deklaruar si shpenzime studimi në Mbretërinë e Bashkuar vlerën 13.150 GBP, ndërsa në pyetësorin e parë ka deklaruar: vlerën 7.450 GBP – tarifë studimi; vlerën 5.700 GBP – shpenzim qiraje; dhe vlerën 3.000 GBP – shpenzime qëndrimi, pra, total vlerën 16.150 GBP.

28.18 Për periudhën 2014 – subjekti në deklaratës periodike vjetore të vitit 2014 ka deklaruar si shpenzime studimi, *master*, vizë dhe qira banese vlerën prej 13.600 GBP për vajzën A. D dhe shpenzime studimi 6.500 GBP për vajzën tjetër G.D (deklaruar në total shpenzime për dy personat e lidhur në Mbretërinë e Bashkuar në vlerën 20.100 GBP), ndërsa në pyetësorin e parë ka deklaruar këto shpenzime përkatësisht: për A.D vlerën 7.550 GBP – tarifë studimi; vlerën 5.700 GBP – shpenzime qiraje; dhe vlerën 3.000 GBP shpenzime qëndrimi, ndërsa për G.D: vlerën 6,600 GBP – shpenzime studimi; dhe vlerën 900 GBP – shpenzime jetese, pra, ne total vlerën 23.750 GBP – shpenzime në Mbretërinë e Bashkuar.

28.19 Në lidhje me shpenzimet e studimit subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit faturat e lëshuara nga ***dhe **** për znj. A. D dhe *** and ***** për znj. G. D, por subjekti i rivlerësimit nuk vuri në dispozicion kontratat për shkollimin e vajzave A dhe G. D, kontratat e akomodimit, si dokumentacion ligjor provues i plotë për të provuar pagesat e kryera.

28.20 Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bursa në formën e zbritjes së detyrimit total të studimit, nga subjekti i rivlerësimit janë deklaruar bursa në vitet akademike 2011- 2012 dhe 2012-2013.

28.21 Komisioni, bazuar në deklaratimet e ndryshme të subjektit të rivlerësimit në deklaratimet periodike dhe gjatë pyetësorit të parë, për shpenzimet e shkollimit dhe jetesës të vajzave A dhe G.D në Mbretërinë e Bashkuar, vlerësoi të kryejë një hetim të pavarur për shpenzimet, kostot e studimeve dhe të jetesës së vajzave të subjektit në Mbretërinë e Bashkuar.

28.22 Trupi gjykues për këtë qëllim kreu verifikimin e të dhënave mbi tarifat e shkollimit dhe kostove të tjera në faqet zyrtare të universitetit respektiv,¹ si dhe kërkoi informacion nëpërmjet komunikimit elektronik², prej Konsullatës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, për:

- a) pagesat e shkollimit për *master* shkencor në “**** and ****”, në vitin 2014 – 2015;
- b) pagesat e shkollimit për studimet *bachelor* në “****”, në vitet 2011– 2014;
- c) pagesat e shkollimit për *master* shkencor në “****”, në vitin 2014 – 2015.

28.23 Gjithashtu, nëpërmjet komunikimit elektronik prej Konsullatës së Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar u kërkua informacion edhe në lidhje me kostot e qirave në zonat ku vajzat e subjektit të rivlerësimit kanë jetuar, si dhe garancitë e nevojshme të kërkua nga universitetet përkatëse.

28.24 Komisioni, pas analizimit të informacioneve të marra në faqet zyrtare të universiteteve respektive dhe informacionit të marrë nëpërmjet komunikimit elektronik nga Konsullata e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, në lidhje me kosto shkollimi për studentët ndërkombëtar në universitetet, ku vajzat e subjektit kishin studiuar, kostot e jetesës apo qerese vlerësoi marrjen në konsideratë si kosto për shpenzimet e shkollimit për vajzat e subjektit, sipas viteve, si vijon:

- a) bazuar në informacionin e marrë për vitin 2011, Komisioni vlerësoi të përlloragiste vlerën 6.412 GBP (1.063.879 lekë), duke i konsideruar si shpenzime shtesë në analizën financiare;
- b) bazuar në informacionin e marrë për vitin 2012, Komisioni vlerësoi të përlloragiste 4.167 GBP (713.707 lekë), duke i konsideruar si shpenzime shtesë në analizën financiare;
- c) bazuar në informacionin e marrë për vitin 2013, Komisioni vlerësoi të përlloragiste 2.292 GBP (385.950 lekë), duke i konsideruar si shpenzime shtesë në analizën financiare;
- d) bazuar në informacionin e marrë, vlera e shpenzime të qëndrimit për vitin 2014, Komisioni vlerësoi të përlloragiste në 2.292 GBP (411.368 lekë) për A.D dhe GBP (75,920 lekë) për G. D, duke i konsideruar si shpenzime shtesë në analizën financiare.

Pasuri

28.25 Në këtë kategori janë pasqyruar të gjitha pasuritë e paluajtshme, të luajtshme, si dhe likuiditetet e deklaruara sipas deklaratimeve periodike të subjektit e bashkeshortit në vitet përkatëse. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndryshimet e kursimeve *cash* duke përcaktuar shtesat dhe specifikuar burimin e krijimit të tyre.

Në përfundim të analizës financiare të kryer për vitet e deklaratimeve periodike 2003 – 2016 rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kishin mungesë likuiditetesh në vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014, për të cilat, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës, iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

¹ <https://www.k.ac.uk/i/s-and-fees/living-costs/>

² Komunikim me e-mail në datat 10.5.2019, 13.5.2019, 14.5.2019, midis Komisionit dhe Konsullatës Shqiptare në Londër.

29. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit parashtroi prova e shpjegime dhe kundërshtime lidhur me analizën ekonomiko-financiare të Komisionit, duke paraqitur edhe akt-ekspertimin e datës 20.11.2019, përgatitur nga studio “A- ****”.

29.1 Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare, duke paraqitur një përlllogaritje tjetër me disa ndryshime në zërat, si më poshtë:

- në të ardhurat për vitet 2011 – 2014;
- ka shtuar gjendjen *cash* në vitin 2014, në shumën 1.600.000 lekë si gjendje *cash* e padeklaruar në DPV-të prej vitit 2004, si dhe pakësuar më pas në *cash* në vitin 2014 për përballimin e shpenzimeve;
- ka shtuar vlerën totale prej 1.199.900 lekësh, si të ardhura nga dietat e bashkëshortit S. D;
- ka zbritur shpenzimet e udhëtimit në vlerën 506.740 lekë për vitet 2011– 2014;
- ka zbritur shpenzime jetese të vajzës G .D në vlerën 161.532 lekë për vitin 2014, në Mbretërinë e Bashkuar;
- ka zbritur të gjitha shpenzimet shtesë për vitet 2011– 2014 në vlerën 2.650.424 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

30. Trupi gjykues, pasi analizoi provat nga hetimi administrativ, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, arsyeton se:

Lidhur me analizën financiare për vitin 2011

30.1 Trupi gjykues, pasi analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, akt-ekspertimin e datës 20.11.2019, të përgatitur nga studio “A- ****”, në të cilin është bërë raporti në lidhje me gjendjen financiare për vitin 2011, si dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuar së bashku, arsyeton se:

30.2 Për sa i përket dietave, në analizën financiare të vitit 2011, subjekti ka pretenduar se dietat e shërbimeve të kryera sipas vërtetimeve të paraqitura në cilësinë e provës në shumën 305.000 lekë, duhen konsideruar të ardhura. Subjekti ka shpjeguar se këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*, pasi aty pasqyrohen vetëm të ardhurat e tatueshme, duke pretenduar se dietat dhe shërbimet sipas vërtetimeve paraqitur në cilësinë e provës duhen konsideruar të ardhura.

30.3 Trupi gjykues, arsyeton se të ardhurat nga dietat e përfituara janë vlera monetare të destinuar për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, sipas nenit 4, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

30.4 Subjekti i rivlerësimit, për sa i përket udhëtimeve, ka kundërshtuar llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit për veten dhe familjarët e saj. Subjekti, në shpjegimet e dërguara në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, ka sqaruar: “*Në lidhje me udhëtimet rezulton se nga Komisioni nuk janë marrë parasysh dokumentet e paraqitura për udhëtimet e kryera në vitet 2004 – 2016, së bashku me përgjigjen dërguar nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019*”.

30.4.1 Trupi gjykues, pasi analizoi kërkesën e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur gjatë hetimit administrativ, arrin në përfundimin të kryejë rillogaritjen në analizën financiare për zërin e udhëtimeve, duke u bazuar në çmimin real për të gjitha biletat e udhëtimit të cilat janë paraqitur nga subjekti nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019³.

³ Lidhur me shpenzimet për udhëtimin e personit të lidhur, vajzës së subjektit, G. D, në Londër, nga data 16.1.2011 –16.6.2011, në vlerën 180 euro, subjekti kishte paraqitur në cilësinë e provës nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019 dy bileta udhëtimi (biletën e vajtes Tiranë - Londër, nr. *** 102.6 GBP (205.2 GBP/2) dhe biletën Londër -Tiranë , nr.*** me çmim 128.84 euro). Trupi gjykues, pasi i administroi dhe vlerësoi biletat e paraqitura nga subjekti, rillogariti shpenzimet e udhëtimit në shumën 252 euro.

30.5 Lidhur me shpenzimet për udhëtimin e personit të lidhur, djalit të subjektit D. D, në Itali në datat 30.6.2011– 4.7.2011, në vlerën 175 euro, subjekti paraqiti në cilësinë e provës dy vërtetime⁴, mbi të cilat mbështeti pretendimin mbi mbulimin e shpenzimeve nga klubi sportiv “D”.

30.6 Trupi gjykues, pasi administroi dhe vlerësoi provat e paraqitura nga subjekti, konstatoi se këto dokumente nuk konfirmonin mbulimin e shpenzimeve, por vetëm pjesëmarrjen e djalit të subjektit në aktivitetin e kryer, për rrjedhojë arriti në përfundimin se subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor provues, mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të djalit të saj nga klubi i futbollit “D”.

30.7 Lidhur me shpenzimet për udhëtimet turistike të realizuara nga subjekti dhe bashkëshorti S. D për datat 26 – 28.11.2011, si dhe të personit të lidhur G. D, për datat 2 – 4.12.2011, në Kroaci me paketë turistike, subjekti paraqiti në cilësinë e provës vërtetimin e lëshuar nga shoqëria e udhëtimeve ATHS sh.p.k., sipas të cilit provohej shpenzimet e udhëtimit për personat e lidhur në periudhat respektive.

30.8 Trupi gjykues, pasi i administroi dhe vlerësoi provat⁵ e paraqitura, arriti në përfundimin se subjekti provoi me dokumentacion ligjor provues, shpenzimin për këto udhëtime dhe rillogarit shpenzimet bazuar në vërtetimet e paraqitura nga subjekti.⁶

30.9 Lidhur me shpenzimet e qëndrimit të xhaxhai S. D, në Bolzano, për udhëtimin e personit të lidhur A. D për datat 15.12.2011 – 1.1.2012, subjekti paraqiti deklaratë noteriale në formën e kërkuar nga ligji nga xhaxhai S. D, për mbulimin e shpenzimeve prej tij.

30.10 Trupi gjykues, pasi i administroi shpjegimet e subjektit, si dhe vlerësoi provat⁷ e paraqitura, vendosi të konsiderojë të provuar mbulimin e shpenzimeve nga xhaxhai dhe llogarit në analizën financiare për këtë udhëtim vetëm shpenzime qëndrimi në vlerën 5 euro/ditë, bazuar në metodologjinë sipas vendimit nr. ***(JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

30.11 Lidhur me udhëtimin në Poznan, Poloni, për datat 26.3.2011– 3.0.2011, të personit të lidhur G. D, subjekti paraqiti në cilësinë e provës vetëm letër rekomandimi⁸ të lëshuar nga E.L.S.A (ELSA).

30.12 Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet dhe provën e subjektit, për këtë udhëtim arriti në përfundimin se dokumenti i lëshuar nga ELSA nuk provonte mbulimin e shpenzimeve por vetëm pjesëmarrjen e vajzës të subjektit në aktivitetin e kryer, për rrjedhojë, shpenzimet e llogaritura në analizën financiare për këtë udhëtim mbeten të njëjta.

30.13 Lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, subjekti ka pretenduar se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2011 duhet të jenë në shumën 1,584 euro apo 219,067 lekë, bazuar në aktekspertimin e datës 20.11.2019.

Lidhur me shpenzimet e udhëtimit të subjektit Nure Dreni dhe personat e lidhur S dhe D.D, në Londër nga data 27.3.2011 – 3.4.2011, në vlerën 180 euro/person, subjekti kishte paraqitur në cilësinë e provës nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019, dy bileta udhëtimit (biletën Tiranë - Londër -Tiranë nr. *****dhe nr. *****, ku secila biletë rezultonte me çmim 193.34 euro/person).

Trupi gjykues, pasi administroi dhe vlerësoi biletat e paraqitura nga subjekti, rillogarit shpenzimet e udhëtimit në shumën 193.34 euro/person.

Lidhur me shpenzimet për udhëtimin e personit të lidhur, vajzës së subjektit, A. D, në Londër, nga data 29.9.2011 – 14.1.2012, në vlerën 180 euro, subjekti kishte paraqitur në cilësinë e provës nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019 dy bileta udhëtimit (biletën e vajtjes Tiranë - Londër, nr. **** 112.5 euro dhe biletën Londër -Tiranë, nr. ****, 167 GBP/2).

Trupi gjykues, pasi i administroi dhe vlerësoi biletat e paraqitura nga subjekti, rillogarit shpenzimet e udhëtimit në shumën 215 euro.

⁴ Vërtetim **pa datë, pa numër protokoll** nga Klubi i Futbollit D, në të cilin përcaktohej se personi i lidhur ka qenë sportist dhe ka qenë pjesëtar i ekipit në turet futbollistike të zhvilluara dhe leje kalimi e datës 4.4.2013, e lëshuar nga drejtori i klubit D.

⁵ Vërtetime të datave 21.2.2019 dhe 11.3.2019 të ATHS-së.

⁶ Rillogaritja për udhëtimet në Kroaci, rezultoi nga 420 euro /3 persona në 269 euro/3 persona.

⁷ Deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. **** kol., datë 8.8.2019, e z. S.D, duke bashkëlidhur edhe pasaportën e tij ku ka konfirmuar mbulimin e shpenzimeve të akomodimit, në Bolzano, Itali.

⁸Dokumentacion në përgjigje të pyetësorit, dërguar nga subjekti datë 12.3.2019.

30.14 Komisioni, pasi administroi pretendimet e subjektit, konstatoi se në akt-ekspertimin ku subjekti mbështet pretendimet e saj nuk janë llogaritur shpenzimet për të gjitha udhëtimet e kryera nga subjekti dhe/apo personat e lidhur për vitin 2011.

30.15 Eksperti i referon vlerat e shpenzimeve të udhëtimit vetëm në mënyrë përmbledhëse në bazë vjetore, por pa sqaruar zërat përkatës për çdo udhëtim. Gjithashtu, eksperti nuk ka paraqitur metodologji mbi mënyrën e përlllogaritjes.

30.16 Trupi gjykues, pas analizimit të deklaratave vjetore, shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, si dhe ato të siguruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, arriti në përfundimin se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2011, duke ju referuar dokumentacionit provues ligjor, për subjektin e personat e lidhur janë rillogaritur nga vlera 403.922 në vlerën 408.942⁹ lekë.

30.17 Subjekti ka pretenduar lidhur me shpenzimet në Londër, duke shpjeguar, ndër të tjera, se koha e qëndrimit të personit të lidhur, vajzës në Mbretërinë e Bashkuar nuk ka qenë për gjithë vitin sepse një pjesë të kohës ka qenë në Shqipëri.

30.18 Trupi gjykues, pas administrimit dhe vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, vlerësoi dhe vendosi se në referim të kërkesave të saj, të rillogarisë shpenzimet duke llogaritur edhe shpenzimet jetike në Shqipëri, për kohën e qëndrimit të personit të lidhur, vajzës së saj, për këtë vit kalendarik.

30.19 Pas administrimit dhe analizimit të shpjegimeve dhe të provave të subjektit të rivlerësimit, lidhur me periudhën e qëndrimit të vajzës A. D në Shqipëri dhe të verifikimit të hyrje- daljeve, sipas sistemit *TIMS*, sipas të cilit që provohet se për vitin 2011 ka qenë në Shqipëri vetëm për datat¹⁰ 1.1.2011–16.1.2011 dhe 16.6.2011 – 29.9.2011, shpenzimet jetike të familjes janë rillogaritur shpenzimet jetike në Shqipëri për vajzën e subjektit A. D për këto data.

30.20 Në konkluzion shpenzimet jetike për vitin 2011 (për familjen me 4 anëtarë dhe për një anëtar (A. D) vetëm shpenzime jetike për datat 1.1.2011–16.1.2011 dhe 16.6.2011 – 29.9.2011, kanë rezultuar në vlerën 592.020 lekë¹¹.

30.21 Për sa i përket shpenzimeve të personit të lidhur në Mbretërinë e Bashkuar për vitin 2011, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, e cila pretendoi se shpenzimet shtesë, nuk duhen konsideruar duke paraqitur edhe dokumentacion shtesë¹².

30.22 Subjekti ka deklaruar shpenzime studimi në Mbretërinë e Bashkuar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 vlerën 13.380 GBP, ndërsa në pyetësorin e parë i ka deklaruar këto shpenzime si: vlera 10.800 GBP – tarifë studimi; vlera 2.580 GBP – shpenzime qiraje; dhe vlerën 2.000 GBP –tarifë qëndrimi – në total vlera 15.380 GBP.

30.23 Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt që garanton të drejtat e palës dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, trupi gjykues vendosi të konsiderojë në analizën përfundimtare financiare të kryer, skenarin më favorizues dhe garantues për subjektin e rivlerësimit, duke marrë në konsideratë si shpenzime shkollimi dhe qëndrimi për këtë periudhë shpenzimet e deklaruara prej tij në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 (duke mos marrë në konsideratë në këtë analizë shpenzimet e qëndrimit e shkollimit të vajzës për këtë vit kalendarik, sipas deklarimeve të subjektit gjatë pyetësorit të parë të cilat ishin më të larta se ato të deklaruara në DPV-në e vitit 2011), si dhe pa llogaritur në analizën financiare asnjë shpenzim shtesë për këtë periudhë kohore.

⁹ Tabelë financiare për vitin 2011.

¹⁰ Konfirmuar nga sistemi *TIMS*.

¹¹ Për më tepër referojuni tabelës financiare më poshtë për vitin 2011.

¹²I. S**** nga ****për pagesën e konviktit për vajzën A.D në periudhën 18.9.2010 – 25.6.2011, në shumën 4.300 GBP.

I. S****nga *** për detyrimin e vitit shkollor 2010 – 2011, për vajzën A. D, në shumën 10.112 GBP.

I S****dhe C. N S**** nga **** për detyrimin e vitit shkollor 2011 – 2012 për vajzën A.D, në shumën 6.650 GBP.

30.24 Analiza financiare përfundimtare për subjektin në vitin 2011 rezulton, si vijon:

Analiza Financiare në Vitin 2011	Rezultate hetimi	Rezultate përfundimtare
Përshkrimi	2011	2011
Të ardhurat	2,371,004	2,371,004
Të ardhura nga paga si gjyqtare	1,549,385	1,549,385
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	706,045	706,045
Të ardhura nga interesat _BKT	115,574	115,574
Detyrime	0	0
Shpenzime	5,127,794	4,114,475
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	546,480	592,020
Shpenzime shkollimi G. D	30,000	30,000
Shpenzime shkollimi A.D	1,791,936	1,791,936
Shpenzime udhëtimi	403,922	408,942
Shpenzime jetese A.D	331,840	331,840
Shpenzime qira A.D	428,074	428,074
Shpenzime extra jetese A.D	1,063,879	
Shpenzime leasing (principal + interes)	358,789	358,789
Shpenzime shkollimi N.D	172,875	172,875
Pasuri	-1,349,712	-1,349,712
Kursime (Pakësim/Shtesa likuiditeti)	- 1,349,712	- 1,349,712
Rezultati Financiar 2011 Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri	-1,407,077	-393,759

30.25 Trupi gjykues, për vitin 2011, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pamjaftueshmëri financiare për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera familjare, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën 393,759 lekë.

Lidhur me analizën financiare për vitin 2012

31. Trupi gjykues, pasi analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, aktekspertimin e datës 20.11.2019, përgatitur nga studio "A- ****", në të cilin është bërë raport financiar në lidhje me gjendjen financiare të tij për vitin 2012, si dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuara së bashku, arsyeton se:

31.1 Për sa i përket dietave, në analizën financiare të vitit 2012, subjekti ka pretenduar se sipas vërtetimeve të paraqitura në cilësinë e provës në shumën 328.000 lekë, duhen konsideruar të ardhura, si dhe ka shpjeguar se këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*, pasi pasqyrohen vetëm të ardhurat e tatueshme.

31.2 Subjekti ka pretenduar se dietat e shërbimeve të kryera sipas vërtetimeve të paraqitura në cilësinë e provës duhen konsideruar të ardhura.

31.3 Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe provat e paraqitura gjatë hetimit administrativ, arrin në përfundimin se të ardhurat nga dietat e përfituara janë vlera monetare të destinuara për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, sipas nenit 4, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

31.4 Për sa i përket udhëtimeve, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime lidhur me rivlerësimin e disa prej shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit. Subjekti, në shpjegimet e dërguara në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, ka sqaruar: "Në lidhje me udhëtimet rezulton se nga Komisioni nuk janë marrë parasysh dokumentet e paraqitura për udhëtimet e kryera në vitet 2004 – 2016, së bashku me përgjigjen dërguar nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019".

31.5 Trupi gjykues, pasi analizoi kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ, arrin në përfundimin të kryejë rillogaritjen në analizën financiare për zërin e udhëtimeve, duke u bazuar në çmimin real për të gjitha biletat e udhëtimit të cilat janë paraqitur prej tij nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019¹³

31.6 Lidhur me shpenzimet e udhëtimit të subjektit dhe katër familjarët e tjerë me paketë turistike në Palma de Majorka (Spanjë) në datat 24 – 31.8.2012, llogaritur nga Komisioni në vlerën 2.250 euro, subjekti paraqiti dokumentacion provues faturën¹⁴ dhe kuponin tatimor në vlerën 1.800 euro.

31.7 Trupi gjykues, pasi administroi provat e paraqitura nga subjekti konstatoi se fatura tatimore nuk provon destinacionin e shitjes së shërbimit ndaj subjektit të rivlerësimit/personave të lidhur, duke arritur në konkluzionin se shpenzimet në analizë për këtë udhëtim mbeten të njëjta.

31.8 Lidhur me shpenzimet e udhëtimit të personit të lidhur, G.D, në Portugali, nga data 24.3.2012 – 3.4.2012, subjekti paraqiti në cilësinë e provës letër rekomandimi¹⁵ të lëshuar nga E.L.S.A (ELSA).

31.9 Komisioni, pasi i administroi dhe vlerësoi shpjegimet dhe provat e subjektit, arriti në përfundimin se dokumenti i lëshuar nga ELSA, provonte anëtarësinë e G. D. E.L.S.A (ELSA) por nuk provonte mbulimin e shpenzimeve për këtë udhëtim dhe, për rrjedhojë, shpenzimet e llogaritura në analizën financiare për këtë udhëtim mbeten të njëjta.

31.10 Lidhur me përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, subjekti ka pretenduar se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2012 duhet të jenë në vlerën 2.973 euro apo 415.838 lekë. Këtë pretendim subjekti e bazon në akt-ekspertimin e datës 20.11.2019.

31.11 Komisioni, pasi i administroi pretendimet e subjektit, konstaton se në akt-ekspertimin ku subjekti mbështet pretendimin e saj, nuk janë llogaritur shpenzime për të gjitha udhëtimet e kryera nga subjekti dhe/apo personat e lidhur për vitin 2012.

31.12 Eksperti i referon vlerat e shpenzimeve të udhëtimit vetëm në mënyrë përmbledhëse në bazë vjetore, por pa sqaruar zërat përkatës për çdo udhëtim. Gjithashtu, eksperti nuk ka paraqitur metodologji mbi mënyrën e përllogaritjes.

¹³ Lidhur me shpenzimet për udhëtimin e personit të lidhur, vajzës së subjektit, G. D, në Londër nga data 29.1.2012 – 21.6.2012, në vlerën 250 euro subjekti kishte paraqitur në cilësinë e provës nëpërmjet postës elektronike në datë 12.3.2019 dy bileta udhëtimi (biletën e vajtjes Tiranë - Londër - Tiranë nr. ***, 167 GBP/2, dhe biletën Londër - Tiranë nr. **** çmimi 143.84 euro). Trupi gjykues, pasi administroi dhe vlerësoi biletat e paraqitura nga subjekti, rillogariti shpenzimet e udhëtimit në shumën 247 euro.

Lidhur me shpenzimet për udhëtimin e personave të lidhur S dhe D. D, në Bolzano, Itali nga data 4.4.2012 – 8.4.2012, në vlerën 100 euro/person (biletat avionit) ndërsa subjekti kishte paraqitur në cilësinë e provës nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019 një biletë udhëtimi (Tiranë – Verona - Tiranë nr. ****, ku rezultonte me çmim 113.08 euro/person).

Trupi gjykues, pasi administroi dhe vlerësoi biletat e paraqitura nga subjekti, rillogariti shpenzimet e udhëtimit (biletat avionit) në shumën 113.08 euro/person.

Lidhur me shpenzimet për udhëtimin e subjektit dhe personit të lidhur, djalit D. D, në Londër nga data 14.6.2012– 21.6.2012 në vlerën 180 euro/person (biletat avionit) subjekti kishte paraqitur në cilësinë e provës nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019 dy bileta udhëtimi (biletën e vajtjes Tiranë - Londër- Tiranë, nr. ****. me çmim 192.27 euro/person).

Trupi gjykues, pasi administroi dhe vlerësoi biletat e paraqitura nga subjekti, rillogariti shpenzimet e udhëtimit (biletat avionit) në shumën 192.27 euro/person.

Lidhur me shpenzimet për udhëtimin e personit të lidhur, vajzës së subjektit, A. D, në Londër nga data 18.9.2012 – 25.3.2013, në vlerën 180 euro (biletat avionit) subjekti kishte paraqitur në cilësinë e provës nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019 dy bileta udhëtimi (biletën e vajtjes Tiranë – Londër, nr. **** 157.92 euro dhe Londër –Tiranë, nr. **** 177 GBP/2).

Trupi gjykues, pasi administroi dhe vlerësoi biletat e paraqitura nga subjekti, rillogariti shpenzimet e udhëtimit (biletat avionit) në shumën 264 euro.

Lidhur me shpenzimet për udhëtimin e personit të lidhur, vajzës së subjektit, G. D, në Londër nga data 16.10.2012 – 4.11.2012, në vlerën 250 euro (biletat avionit) subjekti kishte paraqitur në cilësinë e provës nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019, një biletë udhëtimi (biletën e vajtjes Tiranë - Milano - Londër- Tiranë, nr. ****, 193.56).

Trupi gjykues, pasi administroi dhe vlerësoi biletat e paraqitura nga subjekti, rillogariti shpenzimet e udhëtimit (biletat avionit) në shumën 193 euro.

¹⁴ Faturë dhe kupon tatimor nr. *, datë 1.8.2012 me vlerë 1.800 euro (ose 246.000 lekë).

¹⁵Dokumentacion në përgjigje të pyetësorit, dërguar nga subjekti datë 12.3.2019.

31.13 Për rrjedhojë, trupi gjykues, pas analizimit të deklaratave vjetore dhe deklaratës për rivlerësimin kalimtar të subjektit, shpjegimeve, provave të paraqitura nga subjekti, si dhe ato të siguruar gjatë hetimit administrativ të Komisionit, arrin në përfundimin se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2012 janë rilloparitur nga vlera 687.273 lekë në vlerën 697.775 lekë.

31.14 Subjekti i rivlerësimit, në analizën e vitit ka pretenduar lidhur me shpenzimet në Londër, duke shpjeguar, ndër të tjera, se koha e qëndrimit të personit të lidhur vajzës së subjektit në Mbretërinë e Bashkuar, nuk ka qenë për gjithë vitin sepse një pjesë të kohës ka jetuar në Shqipëri.

31.15 Pas administrimit, analizimit të shpjegimeve dhe të provave të subjektit të rivlerësimit lidhur me periudhën e qëndrimit të vajzave të saj në Shqipëri, si dhe verifikimit të hyrje- daljeve, sipas sistemit *TIMS*, ku konstatohet se vajza A. D ka qenë në Shqipëri për datat¹⁶ 14.1.2012 – 29.1.2012 dhe 21.6.2012 – 18.9.2012, janë rilloparitur shpenzimet, duke shtuar shpenzimet jetike për vajzën në Shqipëri, vetëm për këto data. Në konkluzion, në analizën përfundimtare financiare shpenzimet jetike për vitin 2012 për familjen me 4 anëtarë dhe për një anëtar (A.D, shpenzime jetike për datat 14.1.2012 – 29.1.2012 dhe 21.6.2012 – 18.9.2012), kanë rezultuar në total në vlerën 599.352 lekë.

31.16 Për sa i përket shpenzimeve të personit të lidhur vajzës së subjektit në Mbretërinë e Bashkuar, në vitin 2012, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit e cila në përgjigjet e saj shpjegoi se shpenzimet shtesë nuk duhen konsideruar dhe për të provuar shpenzimet e qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar, subjekti paraqiti dokumentacion shtesë¹⁷.

31.17 Për periudhën 2012 subjekti ka deklaruar si shpenzime studimi në Mbretërinë e Bashkuar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 vlerën 11.350 GBP, ndërsa në pyetësorin e parë i ka deklaruar këto shpenzime si: vlera 6.950 GBP – tarifë studimi; vlera 4.125 GBP – shpenzime qiraje; dhe vlerën 2.700 GBP – shpenzime qëndrimi – në total vlerën 13.775 GBP.

31.18 Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt që garanton të drejtat e palës, si edhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit e objektivitetit, trupi gjykues, vendosi të konsiderojë në analizën përfundimtare financiare, skenarin më favorizues dhe garantues për subjektin e rivlerësimit, duke marrë në konsideratë si shpenzime shkollimi dhe qëndrimi për këtë periudhë shpenzimet e deklaruara prej subjektit të rivlerësimit, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 (duke mos marrë në konsideratë në këtë analizë, finale financiare shpenzimet e qëndrimit dhe të shkollimit të vajzës sipas deklarimeve të subjektit gjatë pyetësorit të parë të cilat ishin më të larta se ato të deklaruara në DPV-në e vitit 2012), si dhe duke mos llogaritur në këtë analizë financiare asnjë shpenzim shtesë për këtë periudhë kohore.

31.19 Analiza financiare përfundimtare për vitin 2012 rezulton, si vijon:

¹⁶ Konfirmuar nga sistemi *TIMS*.

¹⁷ Vërtetim i datës 16.11.2019, nga shoqëria “L.E. A. L”, për qëndrimin me qira të vajzës A. D në një dhomë me çmimin për individ 475 GBP/muaj e ndodhur në një pronë, që ndahej me 5 persona të tjerë për periudhën 29.9.2012 – 28.7.2015.

I. S****dhe C. N S**** nga *** për detyrimin e vitit shkollor 2011– 2012, në shumën 6.650 GBP dhe I.S**** nga **** për detyrimin e vitit shkollor 2012 – 2013, në shumën 6.950 GBP, për vajzën A. D.

Analiza Financiare në Vitin 2012	Rezultate hetimi	Rezultate përfundimtare
Përshkrimi	2012	2012
Të ardhurat	2,511,843	2,511,844
Të ardhura nga paga si gjyqtare	1,589,841	1,589,841
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	826,600	826,600
Të ardhura nga interesat _BKT	61,166	61,166
Të ardhura nga puna A. D	34,236	34,236
Detyrime	0	0
Shpenzime	4,745,155	4,077,606
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	564,096	599,352
Shpenzime shkollimi G. D	60,000	60,000
Shpenzime shkollimi A. D	1,189,701	1,189,701
Shpenzime udhëtimi	687,273	697,775
Shpenzime jetese A. D	462,186	462,186
Shpenzime qira A. D	706,118	706,118
Shpenzime extra jetese A. D	713,307	
Shpenzime leasing (principal + interes)	362,474	362,474
Pasuri	-891,218	-891,218
Kursime (Pakësim/Shtesa likuiditeti)	- 891,218	- 891,218
Rezultati Financiar 2012 Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri	-1,342,093	-674,543

31.20 Trupi gjykues, arriti në konkluzionin se për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur pamjaftueshmëri financiare për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera familjare, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën **674.543 lekë**.

Lidhur me analizën financiare për vitin 2013

32. Trupi gjykues, pasi analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, si dhe aktekspertimin e datës 20.11.2019, i përgatitur nga studio “A- ***”, në të cilin është bërë raport financiar në lidhje me gjendjen financiare të tij për vitin 2013 dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuar së bashku, arsyeton se:

32.1 Për sa i përket dietave, në analizën financiare të vitit 2013, subjekti ka pretenduar se dietat e shërbimeve të kryera sipas vërtetimeve të paraqitura në cilësinë e provës, në shumën 231.400 lekë, duhen konsideruar të ardhura për këtë vit. Subjekti ka shpjeguar se këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*, pasi pasqyrohen vetëm të ardhurat e tatueshme.

32.2 Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ¹⁸, arrin në përfundimin se të ardhurat nga dietat e përfituara janë vlera monetare të destinuar për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës sipas nenit 4, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

32.3 Për sa i përket udhëtimeve të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime lidhur me rivlerësimin e disa prej shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit. Në shpjegimet e dërguara nga subjekti në lidhje me rezultatet e hetimit administrative ka sqaruar: “Në lidhje me udhëtimet rezultojnë se nga Komisioni nuk janë marrë parasysht dokumentet e paraqitura për udhëtimet e kryera në vitet 2004 – 2016, së bashku me përgjigjen dërguar nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019”.

¹⁸ Vërtetim nr. ***, datë 15.3.2019, të lëshuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Vërtetim nr. **** prot., datë 7.2.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

32.4 Trupi gjykues, pasi analizoi kërkesën e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ, arrin në përfundimin të kryejë rillogaritjen në analizën financiare për zërin e udhëtimeve, duke u bazuar në çmimin real për të gjitha biletat e udhëtimit të cilat janë paraqitur nga subjekti nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019¹⁹.

32.5 Lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, subjekti ka pretenduar se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2013 duhet të jenë në vlerën 375.203 lekë. Këtë pretendim subjekti e bazon në akt-ekspertimin e datës 20.11.2019.

32.6 Eksperti i referon vlerat e shpenzimeve të udhëtimit vetëm në mënyrë përmbledhëse në bazë vjetore, por pa sqaruar zërat përkatës për çdo udhëtim. Gjithashtu, eksperti nuk ka paraqitur metodologji mbi mënyrën e përlllogaritjes.

32.7 Lidhur me shpenzimet e udhëtimit nga data 30.12.2013 – 1.1.2014, të personave të lidhur, G dhe A.D, me paketë turistike për në Sofie, Bullgari, janë përlllogaritur nga subjekti në shumën 200 euro/person dhe është paraqitur vërtetim i agjencisë së udhëtimit.

32.8 Trupi gjykues, pasi administroi dhe vlerësoi provën²⁰ e paraqitur nga subjekti, rillogariti shpenzimin për këtë udhëtim, nga çmimi 400 euro/2 persona, në çmimin 198 euro/2 persona, bazuar në vërtetimin e paraqitur.

32.9 Lidhur me shpenzimet e udhëtimit të personit të lidhur, G.D, në Gjermani për datat 8.4.2013 – 17.4.2013, subjekti paraqiti në cilësinë e provës një letër rekomandimi²¹ të lëshuar nga E.L.S.A (ELSA).

32.10 Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet dhe provën e subjektit, arriti në përfundimin se dokumenti i lëshuar nga ELSA konfirmon anëtarësinë në këtë shoqatë dhe pjesëmarrjen dhe udhëtimin e vajzës së subjektit, në udhëtim, por nuk provon mbulimin e shpenzimeve prej kësaj shoqate për këtë udhëtim për rrjedhojë, shpenzimet në analizën financiare mbeten të njëjta.

32.11 Lidhur me shpenzimet e qëndrimit për udhëtimin të personave të lidhur S dhe D.D në datat 8.9.2013 – 15.9.2013, te vëllai i bashkëshortit, z. S.D, në Bolzano, Itali, subjekti paraqiti deklaratë noteriale për mbulimin e shpenzimeve prej tij.

32.12 Trupi gjykues, pasi i administroi shpjegimet e subjektit dhe vlerësoi provat²² e paraqitura nga subjekti, vendosi të konsiderojë në analizën financiare vetëm shpenzime qëndrimi të personave të lidhur në vlerën 5 euro në ditë/person, bazuar në vendimin nr. ***/2019(JR), datë 22.5.2019, të KPA –së.

32.13 Komisioni, pasi administroi dhe analizoi akt-ekspertimin, konstaton se në të nuk janë marrë në konsideratë shpenzime për të gjitha udhëtimet e kryera nga subjekti dhe/apo personat e lidhur

¹⁹ Lidhur me shpenzimet për udhëtimin e personit të lidhur, vajzës së subjektit, A. D, në Londër, nga data 14.4.2013 – 10.7.2013, në vlerën 180 euro (bileta avioni) subjekti kishte paraqitur në cilësinë e provës nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019, një biletë udhëtimi (biletën e vajtjes Tiranë – Londër, nr. *** 177 GBP/2, ndërsa bileta e kthimit u përlllogariti në shumën 90 euro, pra sa ½ e çmimit 180 euro sipas standardit të KPA-së).

Trupi gjykues, pasi administroi dhe vlerësoi biletat e paraqitura nga subjekti, rillogariti shpenzimet e udhëtimit (bileta avioni) në shumën 196 euro.

Lidhur me shpenzimet për udhëtimin e personave të lidhur S dhe D. D, në Firence, Itali, nga data 8.9.2013 – 15.9.2013, në vlerën 200 euro/2 persona (bileta avioni), subjekti kishte paraqitur në cilësinë e provës nëpërmjet postës elektronike në datën 12.3.2019, një biletë udhëtimi (Tiranë- Firence-Tiranë, nr. S***, ku rezultonte me çmim 453 euro/2 persona).

Trupi gjykues, pasi administroi dhe vlerësoi biletat e paraqitura nga subjekti, rillogariti shpenzimet e udhëtimit (bileta avioni) në shumën 453 euro/2 persona.

²⁰ Vërtetim datë 11.3.2019, nga A.T.H.S sh.p.k., për udhëtimin e personit të lidhur në Bullgari.

²¹ Përgjigje të pyetësorit, dërguar nga subjekti datë 12.3.2019.

²² Deklaratë noteriale me nr. **** rep., nr. *** kol., datë 8.8.2019, e z. S.D.

më të për vitin 2013. Për këto arsye, ky akt nuk mund të shërbejë për të mbështetur pretendimet e subjektit për shpenzimet e udhëtimit në këtë vit.

32.14 Trupi gjykues, pas analizimit të deklaratave vjetore dhe të deklaratës së rivlerësimit kalimtar të subjektit, shpjegimeve të subjektit, provave të paraqitura, si dhe ato të siguruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, arrin në përfundimin se shpenzimet e udhëtimit për vitin 2013 janë rillogaritur nga vlera 425.203 lekë në vlerën 437.469 lekë.

32.15 Subjekti i rivlerësimit, në analizën e vitit ka pretenduar lidhur me shpenzimet në Londër, duke shpjeguar, ndër të tjera, se koha e qëndrimit të personit të lidhur, vajzës së subjektit, në Mbretërinë e Bashkuar, nuk ka qenë për gjithë vitin sepse një pjesë të kohës, ka jetuar në Shqipëri.

32.16 Pas administrimit, analizimit të shpjegimeve dhe të provave të subjektit të rivlerësimit, lidhur me periudhën e qëndrimit të vajzës në Shqipëri dhe verifikimit të hyrje-daljeve, sipas sistemit *TIMS*, ku konstatohet se vajza A.D ka qenë në Shqipëri për datat²³ 25.3.2013-14.4.2013, 10.7.2013 – 9.9.2013 dhe 14.12.2013 – 30.12.2013. Shpenzimet jetike për vitin 2013 janë llogaritur për familjen me 4 anëtarë dhe duke shtuar shpenzime jetike në Shqipëri për vajzën A. D vetëm për datat 25.3.2013 – 14.4.2013, 10.7.2013 – 9.9.2013 dhe 14.12.2013 – 30.12.2013. Në konkluzion, shpenzimet jetike për vitin 2013, në analizën përfundimtare financiare kanë rezultuar në vlerën 599.352 lekë.

32.17 Për sa i përket shpenzimeve të personave të lidhur në Mbretërinë e Bashkuar, për vitin 2013, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, e cila në përgjigje shpjegoi se shpenzimet shtesë nuk duhen konsideruar dhe për të provuar shpenzimet reale të qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar, paraqiti dokumentacion ligjor provues shtesë²⁴.

32.18 Lidhur me shpenzimet e personit të lidhur për vitin 2013, subjekti ka deklaruar si shpenzime studimi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 vlerën 13.150 GBP, ndërsa në pyetësonin e parë ka deklaruar këto shpenzime si: vlera 7.450 GBP – tarifë studimi; vlera 5.700 GBP – shpenzime qiraje; dhe vlerën 3.000 GBP – shpenzime qëndrimi – në total vlerën 16.150 GBP.

32.19 Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt që garanton të drejtat e palës, si edhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit e objektivitetit, trupi gjykues vendosi të konsiderojë në analizën financiare të kryer, skenarin më favorizues dhe garantues për subjektin e rivlerësimit, duke marrë në konsideratë si shpenzime shkollimi dhe qëndrimi për këtë periudhë shpenzimet e deklaruara prej subjektit të rivlerësimit, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 (duke mos marrë në konsideratë në këtë analizë finale, shpenzimet e qëndrimit dhe të shkollimit të vajzës për këtë vit kalendarik, sipas deklarimeve të subjektit gjatë pyetësonit të parë, të cilat ishin më të larta se ato të deklaruara në DPV-në e viti 2013), dhe pa llogaritur në këtë analizë finale financiare asnjë shpenzim shtesë shkollimi për vajzën për këtë periudhë kohore.

32.20 Analiza financiare përfundimtare për subjektin në vitin 2013 rezulton, si vijon:

²³ Konfirmuar nga sistemi *TIMS*.

²⁴ Vërtetim i datës 16.11.2019, nga shoqëria “L. E. A. L” (për qëndrimin me qira të vajzës A. D në një dhomë me çmimin për individ 475 GBP/muaj, e ndodhur në një pronë që ndahej me 5 persona të tjerë për periudhën 29.9.2012 – 28.7.2015.

LS**** K.U për detyrimin e vitit shkollor 2012 – 2013, për vajzën A. D në shumën 6.950 GBP.

Analiza Financiare në Vitin 2013	Rezultate hetimi	Rezultate përfundimtare
Përshkrimi	2013	2013
Të ardhurat	2,926,648	2,926,648
Të ardhura nga paga si gjyqtare	1,603,485	1,603,485
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	887,760	887,760
Të ardhura nga interesat _BKT	205,719	205,719
Të ardhura nga puna A. D	229,684	229,684
Detyrime	0	0
Shpenzime	4,213,833	3,875,405
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	564,096	599,352
Shpenzime shkollimi G. D	60,000	60,000
Shpenzime shkollimi A. D	1,254,506	1,254,506
Shpenzime udhëtimi	425,203	437,469
Shpenzime jetese A. D	505,170	505,170
Shpenzime qira A. D	959,823	959,823
Shpenzime extra jetese A. D	385,950	
Shpenzime leasing (principal + interes)	59,086	59,086
Pasuri	-648,449	-648,449
Kursime (Pakësim/Shtesa likuiditeti)	- 648,449	- 648,449
Rezultati Financiar 2013 Të ardhura + detyrime - shpenzime – pasuri	-638,736	-300,309

32.21 Trupi gjykues, arriti në konkluzionin se për vitin 2013 subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur pamjaftueshmëri financiare për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera familjare, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën 300.309 lekë.

Lidhur me analizën financiare për vitin 2014

33. Trupi gjykues, pasi analizoi provat e hetimit administrativ, shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, aktekspertimin e datës 20.11.2019, i përgatitur nga studio “A- ***”, në të cilin është bërë raport financiar në lidhje me gjendjen financiare për vitin 2014, si dhe bazuar në provat dhe faktet e analizuar së bashku, arsyetoi se:

33.1 Për sa i përket dietave, në analizën financiare të vitit 2014, subjekti ka pretenduar se sipas vërtetimeve të paraqitura në cilësinë e provës janë në shumën 335.500 lekë dhe duhen konsideruar të ardhura. Subjekti ka shpjeguar se këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën *Vetting*, pasi pasqyrohen vetëm të ardhurat e tatueshme.

33.2 Trupi gjykues, pasi analizoi provat e paraqitura gjatë hetimit administrativ²⁵, arrin në përfundimin se të ardhurat nga dietat e përfituara janë vlera monetare të destinuar për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, sipas nenit 4, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

²⁵Vërtetim nr. ***, datë 15.3.2019, të lëshuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; vërtetim nr. *** prot., datë 7.2.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

33.3 Subjekti i rivlerësimit, në analizën e vitit ka pretenduar lidhur me shpenzimet në Londër, duke shpjeguar, ndër të tjera, se koha e qëndrimit të personave të lidhur, vajzave të subjektit, në Mbretërinë e Bashkuar, nuk ka qenë për gjithë vitin sepse një pjesë të kohës kanë jetuar në Shqipëri.

33.4 Pas administrimit dhe analizimit të shpjegimeve dhe provave të subjektit të rivlerësimit, lidhur me periudhën e qëndrimit të vajzave në Shqipëri dhe verifikimit të hyrje-daljeve sipas sistemit *TIMS*, trupi gjykues konstatoi se vajza A.D ka qenë në Shqipëri për periudhat 19.6.2014 – 9.9.2014; 21.12.2014 – 3.1.2015 dhe vajza tjetër G. D ka qenë në Mbretërinë e Bashkuar në periudhën 24.9.2014 – 21.12.2014.

33.5 Trupit gjykues, i ka rillogaritur shpenzimet jetike të familjes, duke zbritur shpenzime jetike për periudhën 24.9.2014 – 21.12.2014, për vajzën G.D, si dhe duke llogaritur shpenzime jetike për vajzën tjetër A. D, vetëm për periudhat 19. 6.2014 – 9. 9.2014; 21.12.2014 – 31.12.2014.

33.6 Në konkluzion, në analizën përfundimtare financiare të kryer nga Komisioni, shpenzimet jetike për vitin 2014 për familjen me 4 anëtarë për 9 muaj dhe për 3 anëtarë për tre muaj, si dhe duke llogaritur për një anëtar shpenzime vetëm për datat 19.6.2014 – 9.9.2014; 21.12.2014 – 31.12.2014, kanë rezultuar në total në vlerën 879.992 lekë.

33.7 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, mbi shpenzimet e personave të lidhur në Mbretërinë e Bashkuar, për vitin 2014, e cila në përgjigje shpjegoi se shpenzimet shtesë nuk duhen konsideruar dhe për të provuar shpenzimet reale të qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar paraqiti dokumentacion shtesë²⁶.

33.8 Për periudhën 2014 subjekti ka deklaruar si shpenzime studimi në Mbretërinë e Bashkuar, sipas deklaratës periodike vjetore të vitit 2014, shpenzime studimi *master*, vizë, dhe qira banese vlerën 13.600 GBP për vajzën A. D dhe shpenzime studimi 6.500 GBP për vajzën tjetër G. D (deklaruar në total në DPV 2014 shpenzime për dy personat e lidhur në vlerën prej 20.100 GBP), ndërsa në pyetësonin e parë ka deklaruar këto shpenzime përkatësisht: për A. D vlerën 7.550 GBP – tarifë studimi; vlerën 5,700 GBP – shpenzime qiraje; dhe vlerën 3,000 GBP – shpenzime qëndrimi; për G. D vlerën 6.600 GBP – shpenzime studimi; dhe vlerën 900 GBP – shpenzime jetese (në total vlera 23.750 GBP).

33.9 Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt që garanton të drejtat e palës, si edhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit e objektivitetit, trupi gjykues vendosi të konsiderojë në analizën financiare të kryer, skenarin më favorizues dhe garantues për subjektin e rivlerësimit, duke marrë në konsideratë si shpenzime shkollimi dhe qëndrimi për këtë periudhë shpenzimet e deklaruara prej subjektit të rivlerësimit, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 (për sa shpenzimet e qëndrimit dhe shkollimit të vajzave për këtë vit kalendarik sipas deklarimeve të pyetësonit të parë ishin më të larta se ato të deklaruara në DPV-në e vitit 2014), pa marrë në konsideratë asnjë shpenzim shtesë për këtë periudhë kohore.

33.10 Në lidhje me ndryshimin në gjendjen *cash* të deklaruar nga subjekti në vitin 2014, në rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit ka rezultuar se për këtë vit, subjekti nuk kishte mundësi për të pakësuar gjendjen *cash* në vlerën 1.600.000 lekë, pasi në datën 31.12.2013 ka disponuar *cash* vetëm vlerën prej 44.175 lekësh.

33.11 Pas kalimit të barrës së provës subjekti i ka kundërshtuar rezultatet e Komisionit duke shpjeguar kryesisht se: “Komisioni nuk ka konsideruar të ardhurat *cash* nga likuidimi i bonove të thesarit të vitit 2004 të cilat janë disponuar dhe përdorur *cash* në shtëpi në periudhën 2004 – 2014,

²⁶Vërtetimi i datës 16.11.2019, nga shoqëria “*****” (për qëndrimin me qira të vajzës A. D në një dhomë me çmimin për individ 475 GBP/muaj, e ndodhur në një pronë, që ndahej me 5 persona të tjerë për periudhën 29.9.2012 – 28.7.2015. I S**** në shumën 10.750 GBP dhe C. N S**** në shumën 3.300 GBP, nga *****, duke konfirmuar detyrimin e vitit shkollor 2013 – 2014 për vajzën A. D në shumën totale 7.450 GBP.

si dhe është harruar të shënohet në deklaratën e pasurisë së vitit 2004 si likuiditet pakësimi i gjendjes në bankë (bono thesari) dhe i kaluar në cash, i cili ishte lapsus dhe si i tillë nuk duhet të konsiderohej nga Komisioni se nuk ka ekzistuar kjo shumë”.

33.12 Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, vlerëson se bazuar në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimit të ligjshëm të pasurisë, deklaratat periodike kanë vlerën e provës në procesin e rivlerësimit dhe pakësimi i gjendjes *cash* deklaruar në vitin 2014, si likuiditet *cash* i padeklaruar që nga viti 2004 nuk mund të merret në konsideratë.

33.13 Në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, deklarata e pasurisë për vitin 2004 është provë që vërteton pranimin ose rrëzimin e pretendimeve të subjektit në proces.

33.14 Trupi gjykues i dha deklaratës periodike vjetore të subjektit të vitit 2004 vlerën e provës në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe sipas nenit 11 të Kodit të Procedurës Civile, për të provuar deklaramet e subjektit mbi gjendjen *cash* të pretenduar. Në analizë të deklaratës periodike të vitit 2004, subjekti ka deklaruar se ka pasur gjendje *cash* vlerën 6.500 euro, duke mos deklaruar dhe gjendjen *cash* të pretenduar prej 1.900.000 lekësh të përfituar nga mbyllja e investimit në bono thesari.

33.15 Duke iu referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarameve të subjektit *Vetting* dhe atyre periodike, si dhe deklaramet e subjektit, mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarameve për një subjekt deklarimi vlerësohet vetëm përmes deklarameve të sakta dhe të plota.

33.16 Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e deklarameve të kursimeve në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, në vitin 2004 është i pambështetur në prova dhe në ligj.

33.17 Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarameve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklarameve të sakta dhe të plota. Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin e çdo pasurie, të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

33.18 Përdorimi i gjendjes *cash*, i cili nuk është deklaruar si pakësim është qartësuar dhe konsoliduar nga vendimmarrjet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ku ndër të tjera Komisioni orientohet se: *“Për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen ...të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklarata periodike [...].”*

33.19 Në përfundim, trupi gjykues çmon se analiza ekonomiko-financiare në formë tabelare, e paraqitur nga subjekti, nuk ka vlerë provuese në drejtim të mënyrës së deklaramit të kursimeve të subjektit dhe të personave të lidhur me të, si dhe të mënyrës së përdorimit prej tyre të këtyre kursimeve. Për rrjedhojë, nga trupi gjykues kursimet në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet, u llogaritën sipas deklarameve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratat periodike/vjetore.

33.20 Marrja në konsideratë e likuiditetit të vitit 2004, të pretenduar nga subjekti, është një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003, të ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë e pakësim të pasurisë në çdo formë që ajo ndodh përgjatë një viti periodik.

33.21 Analiza financiare përfundimtare për vitin 2014 rezulton, si vijon:

Analiza Financiare në Vitin 2014	Rezultate hetimi	Rezultate përfundimtare
Përshkrimi	2014	2014
Të ardhurat	3,553,923	3,553,923
Të ardhura nga paga si gjyqtare	1,662,838	1,662,838
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1,057,041	1,057,041
Të ardhura nga interesat _BKT	247,085	247,085
Të ardhura nga puna A. D	442,957	442,957
Të ardhura nga puna G. D	144,002	144,002
Detyrime	3,000,000	3,000,000
Hua 1,000,000 lekë _M.G	1,000,000	1,000,000
Kredi BKT 2,000,000 lekë 06.2014- 12.2014	2,000,000	2,000,000
Shpenzime	8,447,478	8,015,189
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	824,993	879,992
Shpenzime shkollimi G. D	1,184,568	1,184,568
Shpenzime shkollimi A. D	1,355,074	1,355,074
Shpenzime udhëtimi	400,000	400,000
Shpenzime jetese A. D	538,440	538,440
Shpenzime qira A. D	1,023,036	1,023,036
Shpenzime jetese G. D	161,532	161,532
Shpenzime extra jetese A. D	411,368	-
Shpenzime extra jetese G.D	75,920	-
Shpenzime për vizë	140,110	140,110
Shpenzime interesi për huanë e marrë M.G	300,000	300,000
Shpenzime për pagesë kësti _BKT	2,032,437	2,032,437
Pasuri	-43,359	-43,359
Kursime (Pakësim/Shtesa likuiditeti)	- 43,359	- 43,359
Rezultati Financiar 2014 Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri	-1,850,197	-1,417,908

33.22 Trupi gjykues, për vitin 2014, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur pamjaftueshmëri financiare për të përballuar shpenzimet jetike dhe shpenzimet e tjera familjare, duke rezultuar me një bilanc negativ në vlerën 1.417.908 lekë.

34. Në përfundim të analizës financiare të kryer nga Komisioni për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit dhe të personave të lidhur me të, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, për vitin 2011 në vlerën -393.759 lekë; për vitin 2012 në vlerën -674.543 lekë; për vitin 2013 në vlerën -300.309 lekë dhe për vitin 2014 në vlerën -1.417.908 lekë, duke rezultuar me një balancë totale negative në total për vitet 2011 – 2014, prej 2.786.519 lekësh.

Në lidhje me pasuritë e deklaruar nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit

35. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve, të personit të lidhur, nga ku ka rezultuar, si më poshtë vijon:

36. Apartamentin me sip. 155.94 m², ndodhur në Rr. “Sh. I, blerë me kontratën e shitblerjes nr. **, datë 29.6.2001. Vlera: 2.000.000 lekë. Pjesa takuese: personi i lidhur/ S.D 100 %. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat e bashkëshortëve; të ardhurat nga aktiviteti privat i shoqërisë “D” sh.p.k.; të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme, banesë në Kukës, në datën 26.3.2001; si dhe të ardhurat nga shitja e një pjese të magazinës (Kukës), datë 13.12.1995.**

36.1 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, si burim për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme, apartament në Tiranë, deklarohet shitja e apartamentit në Kukës sipas kontratës së shitjes datë 26.3.2001.

36.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti ka deklaruar si çmim të blerjes së apartamentit në Tiranë vlerën 1.900.000 lekë.

36.3 Referuar VKM-së nr. 362, datë 14.7.2000, çmimi mesatar i blerjes për zonën e Tiranës përcaktohet në vlerën 29.201 lekë/m² dhe duke llogaritur bazuar në referencën e mësipërme, çmimi i apartamentit 155.94 m² x 29.201 lekë/m² rezulton se është 4.553.603 lekë.

36.4 Nga sa më sipër, çmimi i apartamentit të blerë nga subjekti është dy herë më i ulët se çmimi referues i miratuar. Për blerjen e këtij apartamenti në Tiranë, si burim krijimi, personi i lidhur ka deklaruar vlerën 2.500.000 lekë nga shitja e apartamentit në Kukës, në datën 26.3.2001.

36.5 Gjatë vitit 2001, në një hark kohor prej tre muajsh, bashkëshorti i subjektit rezultoi të ketë shitur apartamentin në Kukës me sip.78 m², në vlerën 2.500.000 lekë dhe ka blerë në Tiranë apartamentin me sip.155.4 m², në vlerën 2.000.000 lekë.

36.6 Në analizë të transaksioneve, për vitin 2001, rezultoi që çmimi i shitblerjes në të njëjtin vit në Kukës të ketë qenë dy herë më i lartë se çmimi/m², në Tiranë.

36.7 Në lidhje me të ardhurat, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, ka rezultuar se aktiviteti tregtar i shoqërisë “D” sh.p.k., është regjistruar me vendim nr. ***, datë 29.9.1994, nga shtetasit H. Zh dhe S. D dhe është çregjistruar në datën 1.7.1996.

36.8 Me vendimin nr. ***, datë 29. 9.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar shoqëria “D” sh.p.k. me ortak shtetasit H. Zh dhe S. D dhe në degën Tatim Taksat Kukës sipas certifikatës së regjistrimit nr. serial ****. Pas analizimit të përgjigjeve të subjektit, vlerësimit të provave dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, trupi gjykues konstatoi se:

- Nuk ka asnjë bilanc të shoqërisë “D” sh.p.k., që të provojë realizimin e fitimit të kësaj shoqërie në përputhje me ligjin nr. 7661, datë 19.1.1993, “Për kontabilitetin”, i ndryshuar.
- Nuk ka asnjë vendim asambleje për përcaktimin e destinacionit të fitimit, sipas ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”.
- Nuk ka asnjë akt provues ligjor që të provojë nëse ka pasur apo jo detyrime shoqëria ndaj të tretëve në momentin e çregjistrimit të saj. Fakti se shoqëria “D” sh.p.k., rezulton se nuk ka detyrime tatimore të papaguara dhe nuk provon destinacionin e fitimit të realizuar.

36.9 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, si vijon:

- a) Ka mospërputhje në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit midis deklaratës *Vetting* dhe deklarimit periodik të vitit 2003. Për këtë apartament deklaroi si burim: të ardhurat nga pagat e bashkëshortëve; nga aktiviteti privat i shoqërisë “D” sh.p.k.; nga shitja e pasurisë së paluajtshme banesë (Kukës) në datën 26.3.2001; nga shitja e një pjese të magazinës (Kukës) në datën 13.12.1995, ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, deklarohet si burim për krijimin e apartamentit në Tiranë shitjen e apartamentit në Kukës më 2.3.2001.

- b) Nuk provohet përfitimi nga personi i lidhur i fitimit prej shoqërisë “D” sh.p.k., i përdorur nga subjekti si burim për blerjen e apartamentit, si dhe përfitimi nga shitja e aktiveve të trupëzuara pas çregjistrimit të shoqërisë.
- c) Ka mospërputhje në lidhje me çmimin për blerjen e kësaj pasurie pasi: subjekti në deklaratën *Vetting* për këtë apartament deklaroi vlerën prej 2.000.000 lekësh; në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 deklaroi vlerën 1.900.000 lekë.
- d) Çmimi i parashikuar nga palët në kontratën e blerjes së pasurisë në Tiranë është dy herë më i ulët krahasuar me çmimin e referencës përcaktuar në VKM-në²⁷ në fuqi, duket se krijon dyshime se kemi të bëjmë me veprim fiktiv për caktimin e çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 155,94 m², në Rr. “Sh. I”, në vitin 2001 për vlerën 2.000.000 lekë, krahasuar me vlerën e shitjes në të njëjtin vit të apartamentit me sip.78 m², në Kukës në vlerën 2.500.000 lekë dhe çmimin zyrtar të miratuar për këtë vit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

36.10 Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, është shprehur: *“Apartamenti i banimit në zonën kadastrale nr. ****, nr. pasurisë ****, Tiranë, është me sip. 155.94 m², por sipërfaqe e shfrytëzueshme e zotërueshme si banesë është më e vogël, nuk është më shumë se 115 m² pasi në këtë sipërfaqe përfshihen ballkoni afërsisht 30 m², si dhe ambiente të përbashkëta (shkallët oborri dhe truall jashtë sipërfaqes ndërtimore).*

Apartamenti është në një pozicion jo të lakmueshëm, që nuk konkurren në treg, për shkak të katit të parë të banimit, infrastrukturës së shkatërruar, ambienteve të shërbimit poshtë dyshemesë si bilardo dhe bar-kafe deri pasmesnate hapur, garazhe e shtypshkronjë. Apartamenti ynë është i vendosur mbi rrugë kalimin që lidh dy rrugët ‘Sh. I’ dhe ‘A. D’. Për më tepër që pritet dhe një leje zhvillimore që mund ta kthejë në një garazh, pasi 6 metra nga dritaret dhe ballkoni kemi çatinë e komshiut që pritet të marrë leje për zhvillim prone. U cituan këto rrethana që kanë ndikuar dhe ndikojnë edhe sot në çmimin e këtij apartamenti dhe duhet të vlerësoni e gjykoni drejt e jo gjithmonë dyshues.

*I qëndroj të njëjtit shpjegim mbi apartamentin në Kukës, i cili është shitur në vlerën e deklaruar sipas kontratës shitblerjes nr. ***, datë.26.3.2001, për arsye se ishte në zonën me të mirë të Qytetit të Kukësit. Meqenëse nga rezultati i hetimit administrativ është vënë në dyshim çmimi i shitjes dhe blerjes së këtyre pasurive, në kohën kur janë kryer këto transaksione nuk ka pasur arsye/shkak që të na impononte ‘për veprim fiktiv në caktimin e çmimit’ asnjë indicie për të na shtyrë të kryenim veprime fiktive në blerjen e këtyre apartamenteve dhe çmimet janë të vërteta, reale të provuara me dokumentet në formën e duhur ligjor kontratat noteriale.*

*Konstatimi se në deklaratën e pasurisë për vitin deklarues 2003 e kemi shënuar shumën 1.900.000 lekë si çmim të blerjes së këtij apartamenti dhe në deklaratën *Vetting* shumën 2.000.000 lekë, është i saktë. Duke qenë deklarata e parë e plotësuar me shkrim dore para 16 vjetësh, i kemi kushtuar rendësi përmbajtjes pasqyrimin të pasurive dhe burimeve dhe gabimisht është shënuar çmimi në vlerën 1.900.000, pra, është një lapsus (duhet marrë parasysh nga ana juaj gabimi njerëzor).”*

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga trupi gjyqës: *“Së pari marrjen në konsideratë se shuma 6.500 euro nuk është likuiditet/pasuri e krijuar në vitin 2001 por është pasuri gjendje cash e deklaruar në vitin 2003; ë dyti llogaritje te të ardhurave te përfituara nga aktiviteti tregtar i shoqërisë ‘D’ sh.p.k., pasi jemi në kushtet e nenit 32, pika i, e ligjit nr. 84/2016, Së treti: marrjen në konsideratë të të ardhurave nga puna pranë këtij institucioni që nga gushti 1988 deri në maj 1992, fakt i konfirmuar në vërtetimin e sipër cituar për shkak të djegies së arkivit nuk ka të dhëna*

²⁷ VKM-ja nr. 362, datë 14.7.2000.

listëpagesa, kërkoi që për efekt të përlllogaritjes të merren në konsideratë pagat referuese të publikuara në faqen e Institutit të Sigurimeve Shoqërore para vitit 1994 Së katërti: të ardhurat nga puna e bashkëshortit përpara vitit kalendarik 1994, të ardhura, nga aktivitet privat, person fizik, ambulant fruta-perime (biznes i vogël), periudha shtator 1991– dhjetor 1994. ‘Të ardhura nga paga pranë Qendrës Ekonomike të Shëndetësisë Kukës, për periudhën 17.8.1991– 16.9.1992; (ii) pranë Komitetit Ekzekutiv Kukës, për periudhën 16.4.1988 – 16.8.1991; (iii) pranë Parkut Automobilistik Kukës, periudhën 2.3.1986 – 15.4.1988, duke i llogaritur ato me pagë referuese të VKM-së nr. 561, datë 12.8.2005; Së pesti: për shpenzime jetike për vitin 1992-1996, për periudhën deri në vitin 2001 (ku deri në këtë kam jetuar se bashku me familjen në Kukës) të llogariten 30 % të të ardhurave nga paga për mua dhe bashkëshortin.’”

37. Investimi në bono thesari

37.1 Nga hetimi i kryer nga Komisioni për pasuritë, ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit investoi në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, më 21.3.2002, vlerën nominale 5.800.000 lekë, me çmimin e blerjes 5.250.293 lekë.

37.2 Gjithashtu, në vijim bashkëshorti i subjektit më 4.4.2002, investoi në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, vlerën nominale 540.000 lekë, me një çmim blerjeje 488.822 lekë. Për këto investime iu kërkua subjektit të sqarojë në detaje dhe të mbështetur me dokumentacion ligjor provues, burimin e ligjshëm si dhe destinacionin e shumës prej 6.340.000 lekësh, investuar në bono thesari.

37.3 Subjekti në datën 3.10.2019 ka sqaruar ndër të tjera se: *“Në ankandin e zhvilluar me nr. **, datë 19.3.2002, bashkëshorti im S. D, ka investuar në Bankën e Shqipërisë në bono thesari, me afat 1-vjeçar, shumën vlerën nominale 5.800.000 lekë, të cilat janë maturuar, datë 20.3.2003. Sqaroj dhe ju bëjë me dije se kjo shumë i përkiste pjesërisht: i) vlera prej 2.800.000 lekë bashkëshortit tim z. S. D; dhe ii) vlera prej 3.000.000 lekë kumatës sime, znj. D.R.D (bashkëshorte e vëllait të bashkëshortit tim). Në datën 9.4.2003, është tërhequr cash shuma 534.882 lekë, pasi kishte përfunduar afati i investimit për ankandin e zhvilluar me nr. ***, datë 2.4.2002, ku nga shuma e investuar është mbajtur tatimi për interesin, i llogaritur në shumën 5.118 lekë (interesi i përfutur është në shumën 51.177 lekë).”*

37.4 Subjekti e ka mbështetur arsyetimin në këto prova: kontratë porosie, datë 29.12.2001, midis shtetasve D dhe S. D; si dhe 5 akte nxjerrjeje llogarie printuar nga Banka e Shqipërisë në datën 30.9.2019 (fotokopje).

38. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën, si vijon:

38.1 Lidhur me vlerën 3.000.000 lekë, në pronësi të shtetasës D.D (kunata e bashkëshortit), si pjesë e investimit në bono thesari të emetuara nga bashkëshorti i subjektit në Bankën e Shqipërisë në datën 21.3.2002, subjekti ka detyrimin të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor për të provuar mundësinë e kumatës së bashkëshortit për krijimin e kësaj shume si porositëse e kontratës së investimit.

38.2 Duket se nuk është deklaruar në deklaratën vjetore të pasurisë së vitit 2003 mbyllja e investimit në bono thesari, likuiditetet e krijuara, si dhe destinacioni i tyre, si kthimi i vlerës së investuar nga znj. D.D në vitin 2003.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

38.3 Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, shprehet: *“Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në rezultatin e hetimit, ka konstatuar se nga unë subjekti i rivlerësimit nuk është deklaruar si burim*

krijimi të bonove të thesarit në Bankën e Shqipërisë në vitin 2003 mbylljen e investimit në Bankën e Shqipërisë në vitin 2002.

Meqenëse në vitin 2004 (në mars) është bërë deklarimi fillestar për vitin 2003, kam deklaruar të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite (dhe në formularin A1 kam deklaruar si burim të krijimit të pasurisë të ardhurat dhe nga interesat bankare që kanë të bëjnë me investimin në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, pasi në atë periudhë nuk kam pasur të depozituar vlera monetare depozitë në bankë. Në formularin A5 të kësaj deklarate kam deklaruar likuiditet në bono thesari shumën 1.900.000 lekë.

*Për sa i përket konstatimit tuaj të pasqyruar në rezultatin e hetimit administrativ, mbi faktin se 'Në DPV-në 2003 nuk është deklaruar znj. D. D si person tjetër i lidhur me të, e cila ka pasur lidhje pasurore për arsye të investimit të kryer në bono thesari dhe pjesës që ata kanë investuar në emër të saj.' Ju bëj me dije se midis bashkëshortit dhe shtetases D.D (kunata) ka pasur të lidhur një kontratë porosie nr.*** kol., dhe nr. *** rep., datë 29.12.2001, ku është autorizuar bashkëshorti për të investuar për llogari të saj shumën prej 3.000.000 lekësh në bono thesari në Bankën e Shqipërisë dhe është një veprim i kryer gjatë viteve 2002 – 2003.*

Pas tërheqjes së lekëve nga bono thesari, i është kthyer shuma e investuar shtetases D. D (mars-prill 2003) dhe në fund të vitit kalendarik 2003 kam deklaruar gjendjen në fund të vitit (31.12.2003) sipas ligjit dhe nuk kisha detyrim për ta pasqyruar këtë si veprim në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe në deklaratën Vetting.

Parashtroj se kunata znj. D. D, nuk është person tjetër i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ekziston midis saj dhe bashkëshortit tim, ndonjë marrëdhënie dhurimi apo huaje (huadhënie/huamarje), sipas përcaktimit të nenit 32, pika 4 e këtij ligji dhe si e tillë nuk është deklaruar në deklaratën Vetting. Parashtroj se nuk kam pasur detyrimin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, likuiditetin e investuar në bono thesari nga D. D, pasi nuk gëzon cilësinë e personit tjetër të lidhur”.

38.4 Trupi gjykues, pas administrimit dhe analizimit të shpjegimeve e provave të depozituara, me vendimin e datës 10.12.2019, vendosi të rihapë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Nure Dreni, për kryerjen e disa verifikimeve shtesë lidhur me kriterin e pasurisë.

38.5 Lidhur me investimin në bono thesari të bashkëshortit të subjektit në datën 21.3.2002, në shumën 5.800.000 lekë, subjekti ka shpjeguar se nga kjo shumë, vlera prej 3.000.000 lekë, ka qenë në pronësi të shtetases D. D dhe ka paraqitur para Komisionit dokumentacionin ligjor provues për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së kësaj shtetase dhe bashkëshortit, të investuar në bono thesari.

38.6 Komisioni, në kuptim të riçeljes së hetimit, kreu veprimet hetimore, si më poshtë:

38.6.1 Komisioni i kërkoi informacion Bankës së Shqipërisë ku ishin investuar bonot e thesarit nga bashkëshorti i subjektit, me qëllim të vlerësimit të marrëdhënies së investimit në bono thesari në kohën e kryerjes së investimit.

38.6.2 Nga Banka e Shqipërisë është konfirmuar se në periudhën 2001– 2002 ka pasur sportele të bonove të thesarit jo vetëm në Tiranë, por edhe në rrethe. Gjithashtu, në këtë periudhë, nga Banka e Shqipërisë është operuar edhe me llogari dyemërore për pjesëmarrjen e individëve në blerjen e bonove të thesarit sipas përcaktimeve në manualin e punës dhe të rregulloreve në fuqi.

38.6.3 Banka e Shqipërisë, nëpërmjet e-mail-it të datës 5.1.2020, ka vënë në dispozicion Manualin e Operacioneve të Punës mbi blerjet e bonove të thesarit, në kohën e investimit në bono thesari. Në paragrafin 3, të nenit 1, të këtij manuali, parashikohet se: “Në rastet kur klienti paraqitet për të kryer veprime për llogari të të tretëve duhet të ketë me vete prokurë për kryerjen e veprimeve, dokumentacionin e tij personal, si dhe dokumentacionin e të tretit”

38.6.4 Komisioni i ka kërkuar informacion Noterit Publik, i cili ka redaktuar aktin noterial kontratë porosie të datës 29.12.2001, të lidhur midis shtetasve D dhe S.D. Komisioni, gjithashtu, ka verifikuar regjistrin noterial në zyrën e Noterit Publik dhe ka konstatuar se regjistri: “mbyllet me nr. *** rep., dhe me nr. *** kol., viti kalendarik 2001, dhe akti i datës 29.12.2001 është regjistruar me të dhëna: veprim noterial nr. *** rep., datë 29.12.2001, D dhe S. D me nr. *** kol.”

38.7 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua shtesa e barrës së provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për sa vijon:

- a) Nga Banka e Shqipërisë është konfirmuar se në periudhën 2001– 2002 ka pasur sportele të bonove te thesarit jo vetëm në Tiranë, por edhe në rrethe. Gjithashtu, në këtë periudhë, nga Banka e Shqipërisë është operuar edhe me llogari dyemërore për pjesëmarrjen e individëve në blerjen e bonove të thesarit, sipas përcaktimeve në manualin e punës dhe të rregulloreve në fuqi.
- b) Akti kontratë porosie ka parregullsi në drejtim të mbajtjes së ekstremiteteve në identifikimin e regjistrimit, pasi evidentohet se mbyllja e regjistrit noterial është kryer me veprimin e fundit noterial me nr. *** kol., ndërsa kontrata e porosisë është regjistruar me nr. *** kol., për rrjedhojë, nuk duket që akti kontratë porosie të jetë redaktuar në formën dhe sipas procedurave të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

38.8 Subjekti, pas kalimit të barrës së provës të rezultateve shtesë, shprehet: “Për të provuar faktin se në qytetin e Kukësit nuk ka patur sportel të Bankës së Shqipërisë subjekti ka depozituar si provë shkresën nr. ***, datë 12.2.2020, ku konfirmohet fakti se në qytetin e Kukësit nuk ka pasur asnjëherë degë të saj. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj shkrese është sqaruar edhe çështja e mbajtjes së llogarive dyemërore, se hapja e llogarisë dyemërore ka qenë e pamundur për një individ të pajisur me prokurë nga një individ tjetër. Hapja e këtyre llogarive dyemërore ka qenë e mundur vetëm me prezencën fizike, me praninë e të dy personave në emër të të cilëve do të hapej llogaria. Subjekti e ka përmbyllur shpjegimin rreth kësaj çështje se për shkak të pamundësisë për të qenë personalisht në sportelet e bankës të kunatës së saj, ka autorizuar/porositur bashkëshortin e saj, S. D, me kontratën e porosisë nr. **** rep., nr. *** kol., datë 29.12 .2001.

38.9 Lidhur me regjistrimin e kontratës së porosisë, subjekti ka shpjeguar: “...kontrata e porosisë ka qenë e rregullt, ka pasur të gjitha ekstremitetet e nevojshme për një akt noterial bazuar në ligjin 7829, datë 1.6.1994 (ligjin nr. 8790/2001) ‘Për noterinë’, palët janë paraqitur personalisht para noterit dhe kanë shprehur lirisht vullnetin e tyre. Lidhur me regjistrimin e kontratës në regjistër, është përgjegjësi e vetëm noterit pasi ai i administron regjistrat.”

38.10 Subjekti ka sqaruar se: “Nga njohja me faqet e regjistrit noterial, ku është e regjistruar ky veprim noterial (kontrata e porosisë) vërej se numri *** kol., është numri i fundit i pasqyruar në regjistër, ndërsa mbi faktin se noterja e ka të shënuar në mbyllje të regjistrit numrin *** kol., kjo nuk mund të sjellë asnjë pasojë për vlefshmërinë e kontratës së porosisë. “Ky shënim është gabim njerëzor dhe se për këtë vetë noterja ka lëshuar një deklaratë noteriale me nr. ***rep., nr. *** kol., datë 15.2.2020, të deklaruës V. B e cila duhet të pranohet në cilësinë e provës.”

39. Apartament me sip. 60 m², K (Sh. K), Kavajë, blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 3.12.2002. Vlera: 1.980.000 lekë. Në bashkëpronësi mes personit të lidhur S. D dhe H. P, deklaruar si burim të krijimit për 50 % të kësaj pasurie: të ardhura nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes; aktiviteti privat i shoqërisë “D” sh.p.k.; si dhe nga transaksionet e pasurive të paluajitshme të deklaruara.

Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit

39.1 Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur me subjektin ka deklaruar si burim për blerjen e këtij apartamenti: të ardhura nga pagat e tij dhe bashkëshortes; aktiviteti privat i shoqërisë “D” sh.p.k., si dhe transaksionet e pasurive të paluajtshme të deklaruara si burim edhe për pasurinë apartament të ndodhur në Rr. “Sh. I”, Tiranë.

39.2 Subjekti, në deklarinimin e parë të subjektit për vitin 2003 lidhur me këtë pasuri, deklaroi si burim: shitjen e një pjesë të magazinës në Kukës si burim për blerjen e kësaj pasurie.

39.3 Pas hetimit të kryer sa më lart nga Komisioni, kontrata e shitblerjes, datë 3.12.2002, rezultoi të jetë nënshkruar për një çmim 10% më i ulët nga kostot e ndërtimit sipas akt-kolaudimit, 15 % më i ulët nga çmimi mesatar i tregut dhe 30 % më i ulët nga çmimi mesatar i shitjes sipas UKM-së.

39.4 Komisioni kreu analizën financiare për pjesën takuese 50 % të apartamentit në K, nga e cila rezultoi një pamundësi financiare në një diferencë negative prej 845.801 lekësh për blerjen e apartamentit në K, Kavajë.

39.5 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektin iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për sa vijon:

- i. Ka mospërputhje në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, pasi personi i lidhur me subjektin në deklaratën *Vetting* deklaroi si burim, për këtë apartament, të ardhurat e pagave të bashkëshortëve, të ardhurat nga aktiviteti privat i shoqërisë “D” sh.p.k., të ardhurat nga shitja datë 26.3.2001, e pasurisë së paluajtshme banesë (Kukës), si dhe të ardhurat nga shitja datë 13.12.1995, e një pjesë të magazinës (Kukës).
- ii. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti deklaroi burime të ardhurat: nga shitja e një pjesë të magazinës në Kukës, nga aktiviteti privat i shoqërisë “D, nga pagat dhe interesat bankare.
- iii. Nga interesat bankare të bonove të datës 21.3.2002 (pra, nga shuma prej 600.885 lekësh) mund të jenë përdorur si burim për blerjen e kësaj pasurie vetëm vlera e tërhequr prej 60.885 lekësh, pasi shuma prej 540.000 lekësh është rinvestuar.
- iv. Duket se ka pamundësi financiare në një diferencë negative prej 845.801 lekësh për blerjen e apartamentit në K, Kavajë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

39.6 Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, shprehet se: *“Kam për të shpjeguar mbi këtë konstatim të Komisionit, për pamundësinë time financiare në blerjen e këtij apartamenti në pjesën takuese 50 %, nëse nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në analizën financiare do të merreshin parasysh të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shoqërisë ‘D’ sh.p.k., të deklaruara dhe të provuara se janë të ardhura të ligjshme, do të kishim likuiditete në vlerën më të madhe sesa theksova më sipër.*

40. **Autoveturë tip “M.B.C**** CDI”** . Vlera: 900.000 lekë. Burim krijimi për këtë pasuri të luajtshme të deklaruar në deklaratën *Vetting* rezultoi: të ardhurat nga interesat bankare; të ardhurat të përfituara nga kontrata e shitblerjes nr. **** rep., dhe **** kol., datë 6.6.2009 (noter H. S), e automjetit tip “M. B”, i cili është blerë nga subjekti sipas kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., dhe *** kol., datë 12.4.2002. Pjesa takuese: personi i lidhur/S. D, zotëron 100 %.

40.1 Ky automjet është blerë me kontratë shitblerjeje datë 10.3.2009 dhe aktzhdoganimi nr. R***, datë 30.3.2009. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DRSHTRR-ja Tiranë, konfirmohet transaksioni për shitblerjen e automjetit tip “M.B.C***, CDI”, vit prodhimi 2000, ngjyrë gri, mes shitësit E.B dhe blerësit S.D, kundrejt çmimit 3.000 euro, afërsisht 393.000 lekë (sipas kursit të këmbimit), i likuiduar *cash* para nënshkrimit të kontratës së nënshkruar në Gjermani (në gjuhën gjermane). Shitësi E. B e ka sjellë automjetin në Shqipëri më 13.3.2009 dhe ka likuiduar edhe detyrimet doganore në shumën prej 318.000 lekësh, më 30.3.2009.

40.2 Nga sa më sipër, nisur nga fakti se detyrimet doganore në shumën prej 318.000 lekësh rezultonin të likuiduara nga shitësi dhe duke konstatuar se çmimi i kontratës rezultonte 3.000 euro, Komisioni vlerësoi të pyeste subjektin për të sqaruar rrethanat e konstatuara.

40.3 Në përgjigje të tij, subjekti, ka deklaruar: *“Pavarësisht se çmimi i mjetit në kontratë është 3.000 euro, mendoj se duhet pasur parasysh që në përfundim pagesa është bërë jo vetëm për vlerën e mjetit, por edhe për detyrimet doganore që janë paguar për të, të cilat bazuar mbi dokumentet doganore, si dhe në shpenzimet për transportimin e mjetit shkojnë me përafërsi në shumën që është deklaruar në deklaratën për vitin deklarues 2009. Janë kryer shërbimet e zakonshme. Nuk ka pasur nevojë për shërbime kapitale që të kenë rritur vlerën, duke pasur në konsideratë edhe faktin e përdorimit të pakët të tij. Vlera e autoveturës nuk është rritur, përkundrazi, nga konkurrenca, ndryshimet e tarifave doganore dhe amortizimi është shitur afërsisht më pak se vlera në total e paguar. Nisur nga fakti që ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’ në nenet 4 dhe 7 ka të parashikuar se paguhet tatimi mbi të ardhurat personale sipas secilës i nënshtrohet tatimi për të gjitha burimet e të ardhurave, të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura kam menduar se në këtë rast nuk është realizuar fitim nga shitja e mjetit tip ‘M. B C***CDI’, pasi është shitur nën vlerën e pagesës së përgjithshme të kryer nga bashkëshorti im për këtë mjet. Referuar nenit 6 të ligjit nr. 9920/2008, ku është parashikuar se detyrimi tatimor lind kur personi ka realizuar të ardhura, megjithatë në kushtet kur nga ana juaj, më kërkoni që të jap shpjegime për faktin nëse është paguar tatim mbi të ardhurat e realizuar nga shitja, pavarësisht se mendoj që nuk kemi realizuar të ardhura shtesë (fitim), pasi ky mjet është shitur në shumën 4.800 euro nën vlerën/pagesën e kryer në fakt dhe të deklaruar në deklaratën vjetore të pasurisë për vitin 2009 dhe në deklaratën Vetting (çmim blerjeje 3.000 euro + detyrim doganor 318.000 lekë). Në datën 12.6.2019 është arkëtuar në BKT, nga bashkëshorti S. D., tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2017. Po ju paraqes dokumentet ku pasqyrohet pagimi i tatimit mbi të ardhurat individuale, për vitin 2017.”*

40.4 Në lidhje me burimin e të ardhurave nga interesat e bonove të thesarit: nga të dhënat bankare rezulton se për vitin 2009 subjekti ka përfutur interesa nga depozita në BKT²⁸ (në shumën 178.588 lekë) të *maturuara* në vitin 2009 dhe nga investimi në bono thesari në Bankën e Shqipërisë²⁹ (në shumën 152.564 lekë), të arkëtuara datë 29.1.2009.

40.5 Në lidhje me të ardhurat e përfutuara nga shitja e automjetit tip “M.B *** D”, vit prodhimi 1986, datë 6.6.2009, DPSHTRR-ja ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin që provon blerjen e tij, nga personi i lidhur.

40.6 Nga hetimi ka rezultuar se sipas kontratës së datës 12.4.2002 automjeti është blerë kundrejt çmimit 200.000 lekë. Gjithashtu janë likuiduar detyrimet e taksave doganore në shumën prej 150.195 lekësh, bazuar në deklaratën doganore datë 16.4.2002 dhe subjekti ka deklaruar vetëm vlerën prej 400.000 lekësh në deklaratën e parë të pasurive (viti 2004).

²⁸BKT- kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.11.2018 dhe nr. *** prot., datë 9.11.2018.

²⁹ Banka e Shqipërisë përgjigjeje nr. **** prot., datë 23.10.2018 dhe nr. *** prot.

40.7 Këtë automjet, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit e shet kundrejt çmimit 600.000 lekë sipas kontratës së shitblerjes së datës 6.6.2009.

40.8 Gjithashtu konstatohet se shitja e automjetit “M. B *** D” ka ndodhur më vonë në kohë sesa blerja e automjetit “M.B. C ****” dhe, për rrjedhojë, të ardhurat nga shitja e këtij automjeti nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë. Komisioni ka kryer analizën në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e automjetit tip “M.B.C****” referuar burimit të krijimit të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

40.9 Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratat e pasurisë për vitet 2006 – 2010, investimin në bono thesari nga Nure Dreni në Bankën e Shqipërisë me nr. llogarie **** dhe investimin në bono thesari nga bashkëshorti nëpërmjet BKT-së në nr. llogarie ****. Nga ky investim janë përfituar të ardhura në formën e interesave.

40.10 Referuar informacionit të përcjellë nga Banka e Shqipërisë mbi gjendjen dhe kartelën e klientit Nure Dreni rezulton që për vitin 2009, për periudhën janar – mars, të ketë tërhequr në datën 2.2.2009 interesat në shumën 151.564 lekë, nga nr. i llogarisë ****.

40.11 Interesat e gjeneruara nga bonot e thesarit në llogarinë e bashkëshortit në BKT, sipas nxjerrjes së llogarisë bankare, rezultojnë që për vitin 2009 të jenë tërhequr në datën 4.12.2009, pra, pas datës së blerjes së automjetit, duke krijuar pamundësinë e disponimit të kësaj shume.

40.12 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën nga sa vërehet prej Komisionit:

- i. Ka mospërputhje mbi çmimin e blerjes së deklaruar në deklaratën *Vetting*, me çmimin e kontratës në dokumentacionin e DRSHTRR-së Tiranë.
- ii. Në deklaratën *Vetting*, për blerjen e këtij automjeti, rezulton deklarim i një burimi, i cili nuk ishte krijuar ende pasi të ardhurat nga shitblerja e automjetit tip “M. B ***D”, i bardhë, prodhim i vitit 1986, i përkasin një transaksioni më të vonshëm nga transaksioni për blerjen e automjetit tip “M. B C *** CDI”. Interesat bankare dhe vlera e përfituar nga shitja e automjetit të mëparshëm nuk ishin ende të disponueshme për të bërë të mundur pagesën *cash* shitësit në kontratën e datës 10.3.2009. Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën prej 748.436 lekësh për blerjen e kësaj pasurie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

40.13 Subjekti pas kalimit të barrës së provës sqaron: “...në momentin e blerjes së këtij automjeti, janë tërhequr likuiditetet nga gjendja *cash* që disponoja dhe pranohet nga ju. Në momentin kur është shitur mjeti ‘M. B *** D’ datë 6.6.2009, vlera e përfituar nga shitja është tërhequr dhe është përdorur (si kemi deklaruar/plotësuar formularët e deklarimit pasurisë) gjatë vitit 2009. Gjendja *cash*, jo vetëm që është zëvendësuar, por dhe është deklaruar shpesh në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009 si gjendje *cash* e krijuar nga të ardhurat e vitit, shuma 200.000 lekë.

Nuk është shkak që përdorimi i fjalëve të ndryshme apo interpretimi të çojë në konstatimin se nuk ka burim të ardhurash në shumën 748.436 lekë. Prandaj kërkojmë që kjo/gjetje konstatim të rishikohet, bazuar në shpjegimet dhe provat që i janë dërguar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nuk dua të besoj se për çdo shpjegim të dhënë nga ana ime, jo vetëm që nuk e keni marrë në konsideratë, por jeni mundur që t’i interpretoni në atë mënyrë që të arrini të nxirrni përfundimet mbi pamjaftueshmërinë time për aftësinë paguese, kur unë që nga viti 2003 deri në vitin 2009 kam deklaruar gjendje *cash* në shtëpi, gjendje e krijuar nga interesat e përfituar nga bono thesari, nga pagat dhe burime të tjera ndër vite. Nga hetimi juaj nuk merret parasysh që unë përdor likuiditetin gjendjen të deklaruar në shtëpi për të blerë mjetin tip B, kur që nga viti

2002 nuk kam blerë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, por vetëm kam pasur në dispozicion likuiditete si në bankë (bono thesari) dhe gjendje cash. Nisur nga shpjegimet e dhëna më lart, nuk qëndrojnë edhe dy konstatimet e tjera....”.

40.14 Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë të kundërtën e barrës së provës, për sa i përket gjetjeve të Komisionit për pasuritë e deklaruar nga bashkëshorti i subjektit, analizuar në këtë vendim nga pika 35 deri në 40.13.

Konkluzion përfundimtar për vlerësimin e pasurisë

41. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera , në vlerën totale prej -2.786.519 lekësh, për vitet 2011 – 2014, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

42. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

43. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) me raportin nr. **** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. **, datë 16.1.2020, të KDZH-së, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, ku në përfundim ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës.

43.1 Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar. DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Nure Dreni, në detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

44. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni pas hetimit të kryer për këtë kriter arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

44.1 Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

45. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kreu VI, nenet 40 e vijues i tij, si dhe mbi bazën e kritereve të përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku në përfundim ky organ ka lëshuar një raport të hollësishëm. Raporti

për analizën e aftësive profesionale është bazuar në: formularin e vetëdeklarimit dhe tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti; të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Përshkrimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti

46. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, të llojit vendim gjyqësor, një është i vitit 2014, ndërsa dy të tjera janë të vitit 2016.

47. Dokumenti nr. 1: vendimi nr. **, datë 9.10.2014, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, që i përket dosjes nr. ** regj. them., datë regj. 25.7.2014, me palë kërkuese Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, të pandehur shtetasit A. K dhe L. P, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “trafikim i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese (relatore). Me anë të këtij vendimi, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, në seancë gjyqësore publike, ka vendosur “lënie në fuqi të vendimit nr. **, datë 16.7.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë”.

47.1 Çështja është regjistruar për gjykim në datën 25.7.2014 dhe vendimi është dhënë në datën 9.10.2014. Gjykimi ka zgjatur dy muaj e katërbëdhjetë ditë dhe është realizuar në respektim të standardit kohor 9-mujor të përcaktuar nga germa “i”, e nenit 5, të vendimit të ish-KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

47.2 Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

47.3 Në pjesën arsyetuese, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka marrë në shqyrtim vendimin e dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke analizuar përmbajtjen e tij në drejtim të zgjidhjes përfundimtare të çështjes, në drejtim të provueshmërisë së akuzës ndaj secilit të pandehur, kualifikimit ligjor të veprës penale për të cilën janë akuzuar dhe më pas janë gjetur fajtorë të pandehurit, llojin dhe masën e dënimit që ka dhënë Gjykata e Shkallës së Parë për secilin të pandehur, etj. Në arsyetimin e vendimit është përdorur kuadri ligjor penal (Kodi Penal në fuqi dhe në Kodin e Procedurës Penale, vendimi unifikues nr. 4, datë 15.4.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).

47.4 Pjesa e tretë, disponimi i Gjykatës së Apelit, ka të pasqyruar me saktësi konkluzionin e arritur nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në rastin konkret. Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm.

48. Dokumenti nr. 2: vendimi nr. ***, datë 21.10.2016, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, që i përket dosjes nr. *** regj. them., datë regj. 15.7.2016 me palë kërkuese Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, të pandehur shtetasit F. F dhe D.K, të akuzuar për kryerjen e veprave penale “dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, “grup i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal, “kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”, i parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese (relatore).

48.1 Me anë të këtij vendimi, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, në seancë gjyqësore publike ka vendosur “lënie në fuqi të vendimit nr. **, datë 28.6.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë”.

48.2 Çështja është regjistruar për gjykim në datën 15.7.2016 dhe vendimi është dhënë në datën 21.10.2016. Gjykimi ka zgjatur tre muaj e gjashtë ditë dhe është realizuar në respektim të standardit kohor 9-mujor të përcaktuar nga germa “i”, e nenit 5, të vendimit të ish-KLD-së “mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

48.3 Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

48.4 Në pjesën përshkruese të vendimit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka marrë në shqyrtim vendimin e dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke analizuar përmbajtjen e tij në drejtim të zgjidhjes përfundimtare të çështjes, në drejtim të provueshmërisë së akuzës ndaj secilit të pandehur, kualifikimit ligjor të veprës penale për të cilën janë akuzuar dhe më pas janë gjetur fajtorë të pandehurit, llojin dhe masën e dënimit që ka dhënë Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për secilin të pandehur dhe për secilën veprë të kryer, etj. Ka analizuar hollësisht pretendimet e ngritura në ankim nga të pandehurit duke iu dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga secili i pandehur në ankim, si në drejtim të analizës ligjore ashtu edhe analizës provuese. Pra, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka vepruar në këtë rast si gjykatë themeli.

48.5 Në arsyetimin e vendimit është përdorur kuadri ligjor penal (Kodi Penal në fuqi dhe në Kodin e Procedurës Penale, Vendimi Unifikues nr. 2, datë 29.1.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë). Gjithashtu, kjo gjykatë është mbështetur në marrjen e vendimit dhe në praktikën e mëparshme gjyqësore të kësaj gjykate, në praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në Konventën e Kombeve të Bashkuara e ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002, në Protokollin shtesë të Konventës së Palermos. Pjesa e tretë, disponimi i Gjykatës së Apelit, ka të pasqyruar me saktësi konkluzionin e arritur nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në rastin konkret. Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm.

49. Dokumenti nr. 3: vendimi nr. ***, datë 17.5.2016, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, që i përket dosjes nr. *** regj. themeltar, datë regj. 17.5.2016, me palë kërkuese Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, i pandehur shtetasi A.B, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “shtrëngim me anë të kanosjes për dhënien e pasurisë”, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal “grup i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal, ku Gjykata e Apelit ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 9.3.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me këtë ndryshim: mosaplikimin e “pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë”, parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal dhe “lënien në fuqi të këtij vendimi në pjesë të tjera të tij”.

49.1 Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese (relatore). Çështja është regjistruar për gjykim në datën 29.3.2016 dhe vendimi është dhënë në datën 17.5.2016. Gjykimi ka zgjatur një muaj e 18 ditë dhe është realizuar në respektim të standardit kohor 9-mujor të përcaktuar nga germa “i”, e nenit 5, të vendimit të KLD-së “mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

49.2 Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

49.3 Në pjesën hyrëse të vendimit janë përshkruar palët, akuza, çfarë ka disponuar Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin përfundimtar, pretendimet e parashtruara nga prokurori në ankimin e tij ndaj vendimit të shkallës së parë dhe kërkimet përfundimtare të palëve.

49.4 Në pjesën përshkruese, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka analizuar përmbajtjen e vendimit të shkallës së parë në drejtim të zgjidhjes përfundimtare të çështjes, në drejtim të provueshmërisë së akuzës ndaj të pandehurit, kualifikimit ligjor të veprës penale për të cilën është akuzuar dhe më pas është gjetur fajtor i pandehuri, llojin dhe masën e dënimit që ka dhënë Gjykata e Shkallës së Parë për të pandehurin për veprën e kryer prej tij etj. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka analizuar pretendimet e ngritura në ankim nga prokurori, i cili ka kundërshtuar vendimin e shkallës së parë vetëm për sa i takon pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhënë për të pandehurin, duke kërkuar heqjen e kësaj alternative dënimi. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, duke analizuar rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga nenet 47, 48, 49 dhe 50 të Kodit Penal, ka vlerësuar të gabuar vendimin e shkallës së parë vetëm për pezullimin e vendimit

me burgim të dhënë ndaj të pandehurit, duke i vlerësuar të drejta shkaqet e ankimit të parashtruara nga akuza. Pas analizimit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në pjesët e tjera të tij. Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm.

Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short

50. Dosja 1

Çështja penale nr. **regj. themeltar, datë 8.4.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, kundër të pandehurve: 1. A.M, akuzuar për kryerje të veprave penale “vrasje për gjakmarrje” në bashkëpunim, mbetur në tentativë, e parashikuar nga nenet 78/a, 22 dhe 25 të Kodit Penal; “vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër” e parashikuar nga neni 77 i Kodit Penal; “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” e parashikuar nga paragrafi 4, i nenit 278, i Kodit Penal. 2. H. K.M, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “vrasje për gjakmarrje në bashkëpunim”, mbetur në tentativë, e parashikuar nga nenet 78/a, 22 dhe 25 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. **, datë 26.5.2015.

50.1 Me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 23.3.2015, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur për secilin të pandehur: deklarin fajtor të të pandehurit A. Q. M për kryerjen e veprës penale “vrasje për gjakmarrje në bashkëpunim”, mbetur në tentativë, në dëm të shtetasit N. B dhe në bazë të neneve 78/a, 22 dhe 25 të Kodit Penal, dënimin e tij me 30 (tridhjetë) vjet burgim; deklarin fajtor të të pandehurit A. Q. M, për kryerje të veprës penale “vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër” në dëm të shtetasit A.H dhe në bazë të nenit 77 të Kodit Penal, dënimin e tij me 30 (tridhjetë) vjet burgim; deklarin fajtor të të pandehurit A. Q. M, për kryerje të veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe në bazë të paragrafi 4, të nenit 278, të Kodit Penal, dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, i pandehuri A. Q. M dënohet, përfundimisht, me 35 (tridhjetë e pesë) vjet burgim dhe vuajtja e dënimit do të fillojë nga dita e arrestimit të tij, datë 13.11.2013 dhe do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme. Kalimin e akteve për të pandehurin H.K. M, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, etj.”.

50.2 Kundër vendimit të mësipërm kanë ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda të pandehurit A dhe H. M, mbi bazën e të cilit është investuar kjo gjykatë. Subjekti i rivlerësimit në këtë çështje ka pasur cilësinë e relatores.

50.3 Për gjykimin e kësaj çështjeje janë zhvilluar tri seanca, ku në seancën e tretë është shpallur vendimi “lënie në fuqi e vendimit nr.**, datë 23.3.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.”

50.4 Lidhur me përmbajtjen e vendimit me elementet e tij, sipas kërkesave të ligjit procedural, vendimi nr. **, datë 26.5.2015, i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda përmban elementet e përcaktuar nga neni 383 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

50.5 Në pjesën përshkruese-arsyetuese, relatorja ka parashtruar faktet dhe rrethanat e çështjes penale të rezultuara edhe gjatë gjykimit në shkallë të parë, ka disponuar për mospranim kërkesë për përsëritje të pjesshme të hetimit gjyqësor, si dhe ka kryer veprimet procedurale të nevojshme si ballafaqimin midis dy dëshmitarësh dhe ripyetjen e dy dëshmitarëve të tjerë duke arsyetuar vendimin. Gjithashtu, relatorja është ndalur në shqyrtimin e provave që janë administruar edhe gjatë shqyrtimit në shkallë të parë, duke iu dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim. Përmbajtja e provave të shqyrtuara është pasqyruar në mënyrë të hollësishme në pjesën arsyetuese të vendimit, në të cilin i jepet përgjigje edhe pretendimit të të pandehurit H. M., për pafajësi, ku argumentohet se bazuar në nenin 377 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata nuk ndodhet në kushtet e pushimit të çështjes, por as në rastet e pafajësisë, pasi nga shqyrtimi i provave pafajësia

e këtij të pandehuri mbetet e dyshimtë, prandaj duhet vendosur kalimi i akteve për hetime të mëtejshme organit procedues. Në përfundim, arsyetohet se i pandehuri A. M., u gjet fajtor për të tria akuzat e ngritura ndaj tij nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vepruar drejt, si në cilësimin juridik të veprave penale ashtu edhe në drejtim të individualizimit të llojit e masës së dënimit që është caktuar ndaj tij dhe, për pasojë, vendimi duhet lënë në fuqi. Vendimi është cilësuar i drejtë edhe për të pandehurin H. M. Në pjesën arsyetuese, relatorja është shprehur edhe për disponimin e provave materiale, si dhe për faktin se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore.

50.6 Nga pikëpamja e plotësimit të standardeve të përmbajtjes, vendimi i përmban standardet e kërkuara.

50.7 Ndaj vendimit nr. **, datë 26.5.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Kjo gjykatë, me vendimin nr. *****, datë 20.7.2016, ka vendosur “prishjen e vendimit nr. **, datë 26.5.2015, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe vendimit nr. **, datë 23.3.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me trup gjykues tjetër”. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka arsyetuar se: *“Kolegji Penal, duke analizuar në tërësi vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pretendimet e paraqitura në rekurs çmon se, kjo gjykatë, nuk ka respektuar ligjin procedural. Ky Kolegj konstaton se gjykatat e faktit nuk kanë sheshuar çdo kontradiktë dhe kundërtënie në këtë proces dhe arritur në përfundime të drejta tej çdo dyshimi, në lidhje me faktin e ndodhur edhe pse në vendimet e gjykatave janë përmendur dhe analizuar provat e administruara dhe është bërë një analizë e detajuar. Veçanërisht me thëniet e dëshmitarit okular, i cili nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore nuk është konsekuent në shpjegimet e tij, veçanërisht në lidhje me bashkëpunëtorin në vrasje dhe as hetuar në këtë drejtim mbi verifikimin e thënieve të tij në raport me pozicionin, distancat dhe personat pjesëmarrës. Me të drejtë, lidhur me rastin në shqyrtim, nga vendimet rezulton se nuk është bërë një analizë e plotë në lidhje me pozicionin e secilit person, që ka qenë në momentin e ngjarjes, për identifikimin e autorit dhe mundësinë e njohjes nëpërmjet pamjes apo të identifikimit të zërit, etj. Ky identifikim i personit, autorit të veprës penale, ka rëndësi për të përcaktuar tej çdo dyshimi se kush e ka kryer veprën penale. Po kështu, në lidhje me ekzistencën e faktorëve plotësues në tamponët nuk del e qartë dhe nuk rezulton të jetë verifikuar saktë koha e ndodhjes së ngjarjes, momenti i marrjes dijeni nga ana e policisë dhe shoqërimi apo ndalimi i të pandehurit, distancat respektive nga vendi i ngjarjes dhe banesa apo vendi i punës i të pandehurit etj., në analizë të kësaj dinamike dhe kronologjie të dilej në konkluzionin e saktë dhe të pranueshëm nëse i dyshuari kishte kohën e nevojshme dhe mundësitë për të realizuar një manipulim të tillë me provat nëpërmjet heqjes nga mbetjet e faktorëve plotësues. Gjithashtu, masa e dënimit të dhënë për armëmbajtjen pa leje rezulton të jetë mbështetur në një dispozitë tashmë të shfuqizuar. Për sa më sipër, duke qenë se vendimet e gjykatave të faktit janë marrë në mosrespektim të ligjit procedural penal, duhet të prishen dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda”.*

Qëndrimi i Komisionit

50.8 Komisioni, pasi u njoh me vendimin e Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, ankimin dhe rekursin e paraqitur nga të pandehurit, pjesë e dosjes, në kuadër të rivlerësimit sipas kriterit të aftësive profesionale, ka konstatuar se:

50.8.1 Në drejtim të identifikimit të saktë të normës ligjore lidhur me masën e dënimit për veprën penale, të parashikuar nga paragrafi 4, i nenit 278, të Kodit Penal evidentohet se Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda i është referuar një dispozite ligjore materiale, e cila është ndryshuar. Konkretisht, pasi janë analizuar faktet dhe rrethanat lidhur me fajësinë e të pandehurit për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit” bazuar në nenin 278/4 të

Kodit Penal i cituar nga gjykata si i ndryshuar me ligjin nr. 144/2013: “mbajtja e armëve, bombave apo minave, lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet”, kjo gjykatë ka vlerësuar të drejtë përfundimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerje të veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, si dhe dënimin e tij me 10 vite burgim.

50.8.2 Gjykata, në këtë rast, nuk ka arritur të identifikojë ndryshimet e dispozitave të ligjit penal lidhur me këtë dispozitë, pasi në kohën e gjykimit të çështjes pranë kësaj gjykate, ky nen kishte ndryshuar me ligjin nr. 144/2013 dhe me ligjin nr. 98/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohej se: “mbajtja e bombave, minave ose lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.”

Lidhur me qëndrimin e Komisionit, subjektit iu dha e drejta të paraqiste shpjegime

50.9 Lidhur me këtë dosje, subjekti ka sqaruar se në kohën kur është shqyrtuar çështja kanë qenë në fuqi, pikërisht, dispozitat e ligjit material të referuar prej saj, duke u shprehur se për pjesën e konstatimit nga Gjykata e Lartë që ligji që referohej nga gjykata, ku subjekti ishte në cilësinë e kryesueses, ishte shfuqizuar me një ligj tjetër. Kjo dispozitë ka qenë e shfuqizuar në kohën e shqyrtimit nga Gjykata e Lartë, por jo në kohën e shqyrtimit nga Gjykata e Apelit, pra, i është referuar ligjit të kohës së kryerjes së veprës penale.

51. Dosja 2

52.1 Çështja penale nr. *** regj. themeltar, datë 27.12.2013 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kundër të pandehurve E. T dhe L.B, të akuzuar për veprën penale “shtrëngim me anë të kanosjes për dhënien e pasurisë” të kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga paragrafi 1 i nenit 109/b dhe 25 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. *, datë 17.1.2014.

52.2 Nga kjo dosje ka rezultuar se me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 17.12.2013, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur: deklarimin fajtor të të pandehurit E. K. T, për veprën penale “shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë” i kryer në bashkëpunim, vepër kjo e parashikuar nga paragrafi 1 i nenit 109/b dhe neni 25 i Kodit Penal për dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim në bazë të këtyre dispozitave, si dhe të germave “ç” dhe “e”, të nenit 48, të Kodit Penal. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit E. T., me një vit e katër muaj burgim; deklarimin fajtor të të pandehurit L.Y.B për veprën penale “shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga paragrafi 1 i nenit 109/b dhe neni 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të këtyre dispozitave; si dhe në lidhje me gerrat “ç” dhe “e”, të nenit 48, të Kodit Penal me 2 (dy) vite burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimtar të të pandehurit L. B., me një vit e katër muaj burgim. Vuajtja e dënimit për të pandehurit të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme dhe fillon nga dita e arrestimit të tyre, etj.

Kundër vendimit të mësipërm kanë ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda të pandehurit E.T. dhe L.B, duke kërkuar aplikimin ndaj tyre të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

52.3 Çështja është regjistruar në datën 27.12.2013 në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Me shortin e datës 30.12.2013, çështja i është caktuar subjektit të rivlerësimit, gjyqtarës Nure Dreni, si relatores. Në datën 6.1.2014, gjyqtarja Nure Dreni, me aktin urdhërthirrje, ka caktuar seancën

gjqësore në datën 17.1.2014, ora 10:00, duke urdhëruar sekretarinë e gjykatës për njoftimin e palëve, si dhe është caktuar një seancë gjyqësore, që nga verifikimi rezultoi kryesisht produktive.

52.4 Nga përmbajtja e dosjes nuk rezultoi që ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda të jetë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kryesekretarinë e gjykatës në datën 22.1.2014, pas 5 ditëve nga shpallja, në respektim të afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

52.5 Gjykimi i çështjes, nga subjekti i rivlerësimit, është realizuar për 23 ditë në intervalin kohor 30.12.2013 – 22.1.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 9-mujor të përcaktuar nga germa “i”, pika 5, e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

52.6 Janë kryer veprimet procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, të cilat janë dokumentuar rregullisht, gjithashtu janë mbikëqyrur aktet e njoftimit pa pasur vonesa në kryerjen e tyre. Seanca gjyqësore është zhvilluar në sallë gjykimi dhe është dokumentuar me regjistrim *audio*, në funksion të transparencës dhe solemnitetit në gjykim (ka pasur 18 minuta vonesë në fillimin e seancës së parë gjyqësore, për shkak të shoqërimit me vonesë të pandehurve nga policia e burgjeve, por vonesa nuk ka sjellë pengesa në zhvillimin e procesit). Gjyqtarja ka orientuar drejt debatin gjyqësor, si dhe ka vepruar me urdhra dhe vendime të ndërmjetme deri në shpalljen e vendimit.

52.7 Dokumentacioni në dosje është i rregullt. Në procesverbalin gjyqësor vihet re se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, për sa i përket përbërjes së gjykatës, kërkesave paraprake dhe dhënies së fjalës palëve ndërgjyqëse, ka qenë i qartë. Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosjeje është normale. Mënyra e komunikimit është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e saj dhe nuk ka pasur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit relator dhe as për anëtarët.

52.8 Vendimi gjyqësor është dhënë nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka qenë kryesuese e trupit gjykues me 5 gjyqtarë, përmban elementet e përcaktuara nga neni 383 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

52.9 Nga pikëpamja formale, vendimi paraqitet me strukturë të qëndrueshme, janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme. Në përgjithësi, vendimi plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar. Nga analizimi i elementeve të përmbajtura në vendim, evidentohet se në dispozitiv të vendimit nuk janë orientuar palët për të drejtën e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit.

52. Dosja 3

52.1 Çështja penale nr. *** regj. themeltar, datë 22.7.2016 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kundër të pandehurit K. D, i akuzuar për veprën penale “trafikim i narkotikëve” i mbetur në tentativë, i parashikuar nga nenet 283/a/1 dhe 22 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. **, datë 14.9.2016, ku është vendosur lënie në fuqi e vendimit nr. ***, datë 4.7.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për sa i përket cilësimit juridik të fajësisë për të pandehurin për kryerjen e veprës penale “trafikim i narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/1-22 i Kodit Penal. Ndryshimin e këtij vendimi, si më poshtë: dënimin e të pandehurit K. D në bazë të neneve 283/a/1, 22 dhe 23 të Kodit Penal me 4 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i pandehuri dënohet përfundimisht me 2 vjet e 8 muaj burgim. Lënien në fuqi të vendimit nr. **, datë 4.7.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në pjesët e tjera të tij. Shpenzimet gjyqësore në apel i ngarkohen të pandehurit K. D. Vendimi u shpall në Tiranë në datën 14.9.2016.

52.2 Nga verifikimi i dosjes gjyqësore ka rezultuar se me vendimin përfundimtar nr. **, datë 4.7.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është vendosur: deklarimi fajtor i të pandehurit K. K.D, për veprën penale “trafikim i narkotikëve”, mbetur në tentativë dhe në bazë të neneve 283/a/1, 22 dhe 23 të Kodit Penal dënohet me 6 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimtar të të pandehurit K. T., me 4 vjet burgim. Vuajtja e dënimit për të pandehurin fillon të llogaritet nga data 25.6.2016, dita e arrestimit të tij, etj.

52.3 Çështja është regjistruar në datën 22.7.2016, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Me shortin e datës 26.7.2016, çështja i është caktuar subjektit të rivlerësimit, gjyqtarës Nure Dreni, si relatores. Në datën 28.7.2016, gjyqtarja Nure Dreni, me aktin urdhërthirrje, ka caktuar seancën gjyqësore në datën 14.9.2016, ora 13:00, duke urdhëruar sekretarinë e gjykatës për njoftimin e palëve, si dhe është caktuar një seancë gjyqësore.

52.4 Vendimi i marrë i përmban elementet e përcaktuara nga neni 383 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

52.5 Gjykata, në pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitiv, i ka dhënë zgjidhje pretendimeve të parashtruara në ankim dhe ka disponuar për kërkesat e paraqitura në gjykim. Për shqyrtimin në apel, relatorja Nure Dreni është bazuar në të njëjtat prova të marra në shqyrtim edhe nga shkalla e parë, ku pas shqyrtimit ka arritur në përfundimin se vepra penale atribuuar të pandehurit K. D. është konsumuar plotësisht prej tij (nenet 283/a/1 dhe 22 i Kodit Penal). Argumentohet se të pandehurit i është kapur në flagrancë lënda narkotike, e cila i është nënshtruar analizës kimike dhe rezultoi Cannabis Sativa dhe bazuar në vendimin unifikues nr. 1, datë 26.3.2008, të K. B. të GJ. L., doza e gjetur të pandehurit nuk është e vogël që ta përjashtojë nga përgjegjësia penale, pra, i pandehuri duhet deklaruar fajtor. Sqarohet se akuza është pranuar plotësisht edhe nga i pandehuri. Lidhur me kërkesën e përsëritur të pandehurit para gjykatës për uljen e dënimit, gjyqtarja Nure Dreni ka marrë në analizë masën e dënimit të dhënë nga shkalla e parë ndaj të pandehurit K. D., për veprën e kryer, ku argumentohet se megjithëse vepra mbeti në tentativë dhe gjykata iu referua nenit 23 të Kodit Penal për uljen e dënimit, përsëri nuk e ka zbatuar drejt atë dispozitë. Relatorja ka cituar parashikimin e nenit 23 të Kodit Penal dhe në analizë të parashikimit të tij ka çmuar uljen e mëtejshme të masës së dënimit për shkak të sasisë së pakët të lëndës narkotike të kapur, faktit që i pandehuri ka rezultuar përdorues (sipas aktekspertimit toksikologjik), duke e cenuar vendimin e shkallës së parë vetëm për masën e dënimit dhe duke e lënë në fuqi për të gjitha pjesët e tjera, përfshirë këtu deklarinë fajtor, cilësimin juridik të veprës, llojin e dënimit të dhënë, si dhe disponimin për provat materiale.

Për këtë vendim ka pasur mendim pakice nga tre anëtarë të trupit gjykues.

Qëndrimi i Komisionit

52.6 Komisioni, lidhur me analizimin e vendimit për uljen e masës së dënimit, iu referua dispozitës ligjore të përcaktuar në nenin 23/2 të Kodit Penal: *“Gjykata në varësi të shkallës së afërsisë së pasojës, si dhe të shkaqeve për të cilat krimi mbeti në tentativë, zbut dënimin dhe mund ta ulë atë nën minimumin e parashikuar nga ligji ose të caktojë një lloj dënimi më të butë nga ai i parashikuar në ligj”*.

52.7 Është arsyetuar se: “në ndryshim nga sa është vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë, ky kolegji duke i pasur në konsideratë kërkesat e kësaj dispozite, si dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, faktin që është përdorues dhe sasinë e vogël arrihet në përfundimin që masa e dënimit për të pandehurin të zbutet nga sa ka vendosur Gjykata e Shkallës së Parë në vendimin objekt ankimi nën minimumin e dispozitës penale për të cilën u gjend fajtor”.

52.8 Duket se ulja e dënimit në kuptim të nenit 23/2 të Kodit Penal kërkon vleftësimin nga gjykata të shkallës së pasojës, si dhe shkaqeve për të cilat vepra penale “trafikim i narkotikëve” ka mbetur në tentativë, është vendosur pa u vlerësuar shkaqet mbi të cilat veprimet e eksportimit (tregtimit

etj., që lidheshin me trafikimin e narkotikëve) mbeten në tentativë. Përkundrazi, Kodi Penal (në interpretim të nenit 283 të tij) nuk përfshin si shkak për konsumim të veprës penale përdorimin vetjak dhe në doza të vogla të lëndëve narkotike dhe psikotrope.

52.9 Gjithashtu, Komisioni vë re se ulja e dënimit është aplikuar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda nën minimumin e kërkuar sipas germës “a” të nenit 283 “trafikimi i narkotikëve”, sipas nenit 53 “ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji” dhe sipas nenit 23 “përgjegjësia për tentativën” të Kodit Penal, për shkak të mbetjes në tentativë, si dhe duke u konsideruar nga kjo gjykatë disa rrethana lehtësuese të fajtorit në kuptim të nenit 48 të Kodit Penal. Prandaj, për këto arsye duket se nuk ka arsyetim për uljen e mëtejshme të dënimit, sipas vendimit nr. **, datë 14.9.2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

52.10 Lidhur me qëndrimin e Komisionit, subjektit iu dha e drejta të paraqiste shpjegime, për të cilat është shprehur se është e drejtë që të dyja gjykatat kanë disponuar për uljen e dënimit, por Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda ka rivlerësuar rrethanat e kryerjes së veprës penale si mënyra e fshehjes së lëndës narkotike, e mbështjellë në një letër alumini; mënyra e lëvizjes, me autobus, duke kaluar në Pikën e Kalimit Kufitar, ku kontrollet e policisë kufitare janë rigorozë, duke vështirësuar në këtë mënyrë edhe tentativën e eksportimit të lëndës narkotike; faktin që i pandehuri ka rezultuar përdorues i lëndës narkotike, që përputhet me deklarinimin e tij për marrjen e sasisë së pakët të lëndës narkotike për ta transferuar në Greqi, për qëllime përdorimi - elemente këto që tregojnë për një organizim jo të mirë dhe të qëndrueshëm të këtij aktiviteti kriminal nga i pandehuri. Për këtë arsye është disponuar përsëri ulje dënimi në kuptim të parimit të individualizimit të dënimit. Lidhur me këtë vendim, vetëm një anëtar ka qenë në pakicë dhe nuk është ankimuar, çfarë tregon për një vendimmarrje të drejtë.

53. Dosja nr. 4

53.1 Çështja civile antimafia nr. * regj. themeltar, datë 15.7.2016 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me objekt sekuestrim i pasurisë me nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, me indeks hartë K-*****Tiranë, F, të regjistruar në vol. *, f. ***, me emërtimin tokë arë, me sip. 1.000 m², e regjistruar në emër të shtetasit Xh.G. K. Për administrimin dhe përdorimin e pasurive të paluajtshme të ngarkohet znj. B. I, e cila është administratore e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, në Ministrinë e Financave Tiranë. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit Tiranë; kundër shtetasve G.K dhe Xh.K. Baza ligjore, ligji nr. 10192 , datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, e përfunduar me vendimin nr. **, datë 22.9.2016.

53.2 Rezultoi se, fillimisht, çështja e mësipërme u gjykua në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila me vendimin përfundimtar nr.**, datë 28.6.2016, ka vendosur: sekuestrimin e pasurisë me nr. ***, të ndodhur në z. k. ***, me indeks hartë K-***Tiranë, F, e regjistruar në vol. *, f. ***, me emërtimin tokë arë, me sip. 1.000 m², e regjistruar në emër të shtetasit Xh. G. K. Për administrimin dhe përdorimin e pasurive të paluajtshme të ngarkohet znj. B.I, e cila është administratore e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, në Ministrinë e Financave Tiranë. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit Tiranë. Urdhërohet sekretaria gjyqësore pranë kësaj gjykate të dërgojë menjëherë kopje të këtij vendimi në institucionet e mësipërme, si dhe për njoftimin e zotëruesve të pasurive, shtetasve Xh dhe G. K në adresat e tyre të banimit, etj.

53.3 Kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda shtetasi Xh. K nëpërmjet mbrojtësit të tij, z. A.V, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës

për Krime të Rënda dhe rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda, si të pabazuar në ligj dhe prova.

53.4 Çështja është regjistruar në datën 15.7.2016, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Me shortin e datës 20.7.2016, çështja i është caktuar subjektit të rivlerësimit, gjyqtarës Nure Dreni, si relatore. Në datën 22.7.2016, gjyqtarja Nure Dreni, me aktin urdhërthirrje, ka caktuar seancën gjyqësore në datën 12.9.2016, ora 9:30, duke urdhëruar sekretarinë e gjykatës për njoftimin e palëve. Për shqyrtimin e kësaj çështjeje janë zhvilluar dy seanca gjyqësore dhe në përfundim është vendosur “lënia në fuqi e vendimit nr. **, datë 28.6.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Vendimi u shpall në Tiranë në datën 22.9.2016. Seanca u mbyll në orën 12:54.

53.5 Vendimi i marrë i përmban elementet e përcaktuara nga neni 383 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

53.6 Relatorja, në pjesën përshkruese-arsyetuese, fillimisht, ka parashtruar rrethanat e çështjes të rezultuara nga aktet shkresore të shqyrtuara dhe që ndodhen në dosje. Sqarohet se Prokuroria për Krime të Rënda ka filluar hetimin pasuror të shtetasve G. K dhe Xh. K, pasi rezultoi që shtetasi G. K. është dënuar nga drejtësia italiane për veprën penale “trafikim i lëndëve narkotike”. Për shkak të këtij dënimi, Prokuroria për Krime të Rënda i është drejtuar Gjykatës për Krime të Rënda me kërkesë sekuestrimit të një pasurie që ndodhet në pronësi të shtetasit Xh. K., i biri i shtetasit G. K. Gjykata e Krimeve të Rënda e ka pranuar kërkesën, por vendimi i saj kundërshtohet nga shtetasi G. K. dhe Xh. K. Relatorja Nure Dreni arsyeton se vendimi i Gjykatës për Krime të Rënda për marrjen e masës parandaluese ndaj pasurisë së shtetasit Xh. K. është i ligjshëm, pasi plotësohen kërkesat e nenit 11, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm (vendimi përkatës i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda në Milano, Itali), sipas të cilit shtetasi G. K. është gjetur fajtor për përfshirje në veprimtari kriminale (trafikimi i drogës). Së dyti, plotësohet kërkesa tjetër e nenit 11 të ligjit të sipërcituar sipas të cilit, shtetasi Xh. K. zotëron pasuri që dukshëm nuk i përgjigjet nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme. Ky fakt konfirmohet me prova sikurse është marrja e të dhënave nga bankat dhe institucionet e tjera shtetërore, ku sqarohet se shtetasi G. K. dhe Xh. K. nuk kanë aktivitete të ligjshme me të cilat të krijojnë të ardhura. Relatorja arsyeton se shtetasi G. K. është gjithashtu, subjekt i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, pasi vepra penale e kryer prej tij në Itali parashikohet si e tillë edhe në nenin 283/a/2 të Kodit Penal. Relatorja Nure Dreni argumenton se në bazë të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, subjekt i atij ligji janë edhe familjarët, shtetasi Xh. K. është i biri i shtetasit G. K. Argumentohet gjithashtu se i dyshuari Xh. K. mund të kryejë transaksione mbi pronën e sekuestruar të persona të tjerë, prandaj referuar parashikimit të germës “a”, të nenit 11, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 duhen marrë masa parandaluese, duke rrëzuar kështu pretendimin e ngritur në ankim nga ankuesit. Gjykata e Apelit ka argumentuar edhe faktin se shtetasi G. K. dhe Xh. K. në bazë të nenit 18 të Kodit të Procedurës Civile kanë barrën e provës për të provuar se pasuritë e sekuestruara janë krijuar me burime të ligjshme, gjë që nuk u provua prej tyre.

53.7 Së fundi, subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, ka sqaruar se provat e palëve marrin vlerë të plotë kur të diskutohet në themel gjykimi i konfiskimit të pasurisë dhe se në këtë fazë mjafton të krijohet dyshimi i arsyeshëm për paligjshmërinë e pasurisë dhe se është e mjaftueshme marrja e masës parandaluese nëpërmjet sekuestrimit të pasurisë së të dyshuarve dhe se kjo masë e marrë nga Gjykata për Krime të Rënda u është komunikuar ankuesve rregullisht. Si përfundim, është gjetur plotësisht i drejtë vendimi i shkallës së parë të gjyqimit dhe u vlerësua i pabazuar ankimi i shtetasve G. K. dhe Xh. K.

53.8 Për shkak të ndërjegjësisimit mediatik lidhur me vendimin nr. **, datë 5.7.2017, të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, i cili ka ndryshuar vendimin nr. **, datë 17.4.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda me objekt vënien e masës së sekuestrimit mbi pasuritë e

shtetasve A. P dhe M. N, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, Komisioni është i interesuar të njihet me mendimin e subjektit lidhur me interpretimin e dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 në këtë çështje, në referim edhe të interpretimit të bërë prej saj në çështjen nr. 4 të sipëranalizuar duke e parë nën dritën e rasteve ku subjekti ka zbatuar të njëjtin ligj.

53.9 Subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me këtë konstatim tuajin, më lejoni të evidentoj së pari që vendimi nr. **, datë 5.7.2017, i Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda është një vendim që nuk përfshihet në periudhën e rivlerësimit. Së dyti, ju referoni ekzistencën e ‘akuzave mediatike’, për të cilat unë nuk jam vënë në dijeni, që të kuptoj nëse ato janë denoncime në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Së fundmi, pavarësisht sa parashtrova më lart, duke vlerësuar transparencën e këtij procesi rivlerësimi dhe duke qenë e bindur në bazueshmërinë e vendimeve që unë kam dhënë gjatë karrierës sime të gjatë si gjyqtare, më lejoni t’ju sqaroj sa më poshtë vijon: Për sa i përket konstatimit tuaj, me përgjegjësi të plotë deklaroj se nga unë, subjekti i rivlerësimit, dispozitat e ligjit parandalues (nr.10193/2009) janë zbatuar me përpikëri/korrektësi në të gjitha çështjet në të cilat unë kam marrë pjesë me cilësinë e gjyqtarit, si pjesë e trupit gjykues (anëtar ose relatore). Ju kërkoni mendimin tim në lidhje me interpretimin e ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 ‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë’, duke iu referuar vendimit nr. **, datë 5.7.2017, të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda.*

*Në lidhje me këtë konstatim, theksoj se mendimi dhe interpretimi im në lidhje me këtë ligj dhe zbatimin e tij në rastin konkret, është shprehur në vendimin nr. **, datë 5.7.2017, vendim të cilin po ua dërgoj së bashku me këto parashtrime. Gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtares, në përmbushjen e funksionit për dhënien e drejtësisë kam njohur dhe zbatuar ligjet, si dhe kam qenë e pavarur dhe e paanshëm gjatë ushtrimit të detyrës. Në ligjin procedural civil dhe penal normohet parimi i bindjes së gjyqtarit, që është i detyruar që vendimin ta mbështesë në provat të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, duke arsyetuar mbi vërtetësinë dhe fuqinë e tyre provuese.*

Në kushtet kur më kërkohet mendim mbi zbatimin e ligjit parandalues (nr.10192/2009), duke e krahasuar këtë rast me rastet e tjera ‘ku ju keni zbatuar të njëjtin ligj’ e vlerësoj të arsyeshme të citoj ligjin ku parashikohet sekuestroja si masë parandaluese, mbi bazën e të cilit kam krijuar bindjen time nëse janë plotësuar kushtet për të vendosur sekuestron në zbatim të këtij ligji. Vetëm në rastet kur vërtetohen kushtet e parashikuara në këtë ligj duke provuar se ekzistojnë indicie për përfshirjen e personave në veprat penale, ku shtrihet fusha e zbatimit të këtij ligji dhe rrezik real për tjetërsimin e pronës, është e pranueshme dhe duhet vendosur sekuestrimi si masë parandaluese.”

54. Dosja 5

54.1 Çështja penale nr. *** regj. themeltar, datë 4.11.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me objekt vleftësimin e ligjshëm të “arrestimit në flagrancë” dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasit nën hetim L. X, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, “krijim i grupit të strukturuar kriminal” dhe “kryerje e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 283/2-28/4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 11.11.2015.

54.2 Rezultoi se, fillimisht, çështja e mësipërme u gjykua në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila me vendimin nr. ***, datë 19.10.2015 ka vendosur “vleftësimin e ligjshëm të arrestimit të kryer nga Policia Gjyqësore e Drejtorisë së Policisë Vendore Durrës, datë 17.10.2015, ora 13:30, ndaj shtetasit L. X. Caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”,

parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj shtetasit L. X, i dyshuar se ka kryer veprat penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, “krijim i grupit të strukturuar kriminal” dhe “kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 283/2-28/4, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, etj.

54.3 Kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim personi nën hetim L. X në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës për Krime të Rënda, vlerësimin e paligjshëm të arrestit dhe revokimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të caktuar ndaj tij.

54.4 Kjo çështje është regjistruar në datën 4.11.2015, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Në të njëjtën datë, çështja i është caktuar subjektit të rivlerësimit, gjyqtarës Nure Dreni, si relatores, bazuar në urdhrin e kryetarit të gjykatës nr. *** prot., datë 3.10.2015, “Mbi grafikun e gjyqtarëve të gatshëm për muajin nëntor 2015”. Nga aktet e njoftimit, drejtuar palëve dhe të ndodhura në dosje, rezultoi se në datën 5.11.2015, gjyqtarja Nure Dreni, ka caktuar seancën gjyqësore publike për shqyrtimin e çështjes në datën 11.11.2015, në orën 10:30. Është zhvilluar vetëm një seancë me regjistrim *audio*. Pasi ka kryer të gjitha veprimet procedurale dhe ka shqyrtuar ankimin në përfundim ka vendosur: “Miratim i vendimit nr. ***, datë 19.10.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. U shpall në Tiranë, në datën 11.11.2015. Seanca është mbyllur në orën 10:48:34. Nga përmbajtja e dosjes nuk rezultoi të jetë ushtruar rekurs ndaj vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda”.

54.5 Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 16.11.2015, pas 5 ditëve nga shpallja, duke respektuar afatin 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 7 ditë, në intervalin kohor 4.11.2015 - 11.11.2015, duke respektuar afatin 10-ditor të përcaktuar nga pika 5, e nenit 249, të Kodit të Procedurës Penale. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar të përcaktuar nga pika 2, e nenit 28, të Kushtetutës dhe nga pika 3, e nenit 5, të KEDNJ-së.

54.6 Dokumentacioni në dosje është i rregullt. Në procesverbalin gjyqësor vihet re se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, për sa i përket përbërjes së gjykatës, kërkesave paraprake dhe dhënies së fjalës palëve ndërgjyqëse, ka qenë i qartë. Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosjeje është normale.

54.7 Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 11.11.2015, përmban elementet e përcaktuara nga neni 245 i Kodit të Procedurës Penale dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Dispozitivi i vendimit është i qartë dhe i kuptueshëm, por nuk tregohet e drejta e ankimit (rekursit) ndaj vendimit.

Analiza e gjetjeve

55. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Aftësitë profesionale

56. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes analizon në çdo rast kualifikimin ligjor të bërë nga shkalla e parë e gjykimit për veprën penale të konsumuar nga i pandehuri; vlerëson caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, që i duhet dhënë të pandehurit, në respektim të kërkesave të ligjit penal, nenit 47 të Kodit Penal, si dhe njeh dhe zbaton dispozitat e ligjit antimafia për marrjen e masave parandaluese në kuadër të hetimit penal për pasuritë e paligjshme.

Arsyetimi ligjor

57. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme, respekton rregullat e drejtshkrimin dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje pretendimeve të ngritura nga palët në ankim. Gjyqtarja i kushton vëmendje mënyrës së zgjidhjes së çështjes nga gjykata më e ulët, argumenton kur zgjidhja e dhënë prej saj është e saktë dhe kur është e gabuar dhe jep përgjigje për pretendimet e parashtruara në ankimin ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja dhe nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Qëndrimi i Komisionit

58. Nga analizimi i dosjeve të përzgjedhura në short është evidentuar se subjekti i rivlerësimit, në disa raste, nuk ka zbatuar drejt ligjin në drejtim të uljes së masës së dënimit. Subjekti zbaton në mënyrë të ndryshme dispozitat e ligjit antimafia për marrjen e masave parandaluese në kuadër të hetimit penal për pasuritë e paligjshme.

Aftësitë organizative

59. Subjekti rivlerësimit, znj. Nure Dreni, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Sipas vërtetimit nr. ** prot., datë 24.1.2017, të lëshuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda gjyqtarës Nure Dreni gjatë periudhës objekt vlerësimi, i janë caktuar, si relatore, 42 çështje për vitin 2014, 35 çështje për vitin 2015 dhe 50 çështje për vitin 2016, gjithsej, në të tria vitet objekt i këtij vlerësimi i janë caktuar 127 çështje dhe ka të mbartura për vitin 2017 vetëm 5 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, është 96 %.

59.1 Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 13.3.2014 – 8.10.2016, gjyqtarja Nure Dreni ka përfunduar 124 çështje, nga të cilat 122 çështje penale dhe 2 çështje civile antimafia. Nga gjykimet penale, vetëm 61 prej tyre janë penale themeli dhe 63 të tjerat janë kërkesa penale ose masa sigurimi.

59.2 Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, gjyqtarja e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është subjekt ndaj të cilit zbatohet vendimi i ish-KLD-së nr. ***, datë 14.4.2010, “Sistemi Vlerësimi të Gjyqtarëve, Aneksi 1, Për kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”. Rrjedhimisht, analiza e të dhënave të tij bëhet në referencë të këtij vendimi dhe të ligjit procedural për çështje të veçanta, sipas germës “j” të pikës 3 dhe të vendimit të ish-KLD-së, kjo gjyqtare, si relatore, gjykon jo më pak se 20 çështje penale në vit.

59.3 Në analizë të të dhënave mund të thuhet se subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, përgjithësisht, është eficient dhe efektive, duke respektuar kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së saj ka ndikuar edhe ngarkesa e pakët sasiore. Në të gjitha rastet e vëzhguara gjykimet kanë përfunduar brenda afateve të arsyeshme. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

60. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Në pesë prej dosjeve të vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me tri seanca, nga të cilat dy ka qenë joproduktive, por jo për faj të gjyqtarës, në një seancë ka përfunduar gjykimin i dosjes nr.

* dhe seanca ka qenë produktive. Gjykimi i dosjes nr. ** u realizua në një seancë, e cila ishte produktive. Gjykimi i dosjes nr. ** u realizua në dy seanca nga të cilat, vetëm një seancë ishte joproduktive. Gjykimi i dosjes nr. ** u realizua në një seancë të vetme, e cila ishte produktive.

60.1 Si mangësi u konstatua fakti, që dy seanca kanë filluar me më shumë se 10 minuta vonesë nga orari i planifikuar, por vonesat nuk i kanë kaluar 20 minutat dhe nuk është bërë shkak për dëshkrimin e seancës. Pozitiv është fakti që të gjitha seancat gjyqësore janë zhvilluar në salla gjyqi me regjistrim *audio*, në funksion të transparencës së gjykimit.

Aftësia për të administruar dosjet

61. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi te gjyqtarja Nure Dreni, në aftësinë për të administruar dosjet. Procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal. Në katër nga pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, janë inventarizuar aktet procedurale.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

62. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, konstatohet se nga data 20.2.2004 e në vazhdim, ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda.

62.1 Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8.10.2013 – 8.10.2016”, për gjyqtaren Nure Dreni nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së, dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Integriteti

63. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

64. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Nure Dreni, për të cilën në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

64.1 Si në tri dokumentet ligjore ashtu edhe në pesë dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, të mos ketë respektuar rregullat procedurale.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

65. Aftësitë e komunikimit në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara dhe në procesverbalin gjyqësor në format letër nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit Nure Dreni me palët ndërgjyqëse. Nga dëgjimi i kasetës që i bashkëlidhet dosjes gjyqësore rezultoi se komunikimi i gjyqtares me palët pjesëmarrëse në proces ka qenë korrekt dhe në respektim të normave etike. Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

Aftësia për të bashkëpunuar

66. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Nure Dreni për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Gatishmëria për t'u angazhuar

67. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Nure Dreni ka marrë titullin jurist nga Universiteti i Tiranës, në datën 9.6.1988. Pas studimeve, në datën 1.8.1991, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, detyrë të cilën e ka ushtruar deri më 1.4.2001. Në vijim, më 1.4.2001 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku ka vazhduar deri në datën 20.2.2004, kohë në të cilën është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, ku vazhdon edhe aktualisht. Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës së gjyqtares, znj. Nure Dreni ka bërë përpjekje të mëtejshme për përgatitjen teorike dhe ngritjen profesionale. Kështu, subjekti ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit se zotëron titullin Master Profesional në shkencat juridiko-penale, me nr. ***, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, në Universitetin J. I, ku pasqyrohet fakti se: “Nure A Dreni ka filluar studimet Master në vitin 2010 dhe ka mbaruar në vitin 2012”, ku është diplomuar “Master Profesional” në shkencat juridiko-penale.

67.1 Për shkak të funksionit që kryen, znj. Nure Dreni i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, gjyqtarja ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 15 seminare me 28 ditë trajnimi gjithsej, të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Komisioni, pasi administroi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, në lidhje me dosjet profesionale të shortuara, duke mbajtur në konsideratë sa parashikohet nga vendimi nr. 2 /2017 i Gjykatës Kushtetuese: “*Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale*”, vlerëson se në vlerësimin tërësor për kriterin profesional gjetjet e konstatuara nuk janë në atë masë që të shërbejnë si provë për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni, dhe të ndikojnë në arritjen e nivelit kualifikues të subjektit të rivlerësimit në këtë kriter.

DENONCIMET

68. Në Komision janë regjistruar denoncimet e mëposhtme, që janë analizuar në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

68.1 Denoncim i shtetas L. P me nr. *** prot., datë 23.12.2019 drejtuar ndaj disa subjekteve, një ndër këta edhe subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë, të cilët kanë shqyrtuar ankimin kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda për mosfillimin e procedimeve penale lidhur me disa vendime të dhëna nga disa subjekte rivlerësimi (prokurorë) për mosfillimin e procedimit penal ndaj disa nëpunësve të ZVRPP-së Durrës për shkak të abuzimit me kompetencat e tyre. Në denoncimin e saj, shtetasja ka pretenduar për shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e kryesueses lidhur me njoftimin e kryer ndaj saj, marrjen e vendimit në mënyrë të shpejtë dhe se nuk ka qenë dakord me vendimin e marrë nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë.

Komisioni, pasi administroi faktet e trajtuara në këtë denoncim dhe dokumentacionin bashkëlidhur denoncimit, ka parasysh vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 11/2004 dhe nr. 11, datë 2.4.2008, lidhur me “kontrollin” e ushtruar prej tij në formën e rivlerësimit profesional të veprimeve të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet elementit të aftësisë për të gjykuar, por duke mos u kufizuar vetëm në të, si dhe pa ndërhyrë në vlerësimin e vendimeve gjyqësore të marra nga subjekti, të cilat kontrollohen nga një gjykatë më e lartë. Nën këtë kontekst, Komisioni, në vlerësimin e këtij denoncimi iu referua ankimit të denoncueses lidhur me shkeljet procedurale të kryera sa i përket njoftimit nga subjekti i rivlerësimit. Lidhur me këtë pretendim të denoncueses, Komisioni vuri re se ankuesja kishte kërkuar përjashtimin e subjektit për shkak se nuk ishte njoftuar sikurse e kërkon

ligji. Me vendimin nr. ***, datë 13.8.2019, të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda është vendosur mospranimi i kërkesës për përjashtim të subjektit.

Në vlerësim të vendimit dhe të akteve të sjella nga denoncuesja, Komisioni vlerëson se nuk ka pasur shkelje në drejtim të njoftimit të kryer ndaj saj, pasi duke konsideruar natyrën e shpejtë të çështjes në shqyrtim dhe duke konsideruar dispozitën e parashikuar në pikën 5, të nenit 291, të Kodit të Procedurës Penale ku parashikohet se: *“Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit brenda 10 ditëve. Gjykata e Apelit vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve”*, subjekti i rivlerësimit ka vendosur që njoftimi të kryhet edhe me telefon si mjet i njohur sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 133, të Kodit të Procedurës Penale, në rastet e ngutshme dhe se denoncuesi ka marrë dijeni për njoftimin e kryer.

68.2 Denoncimi i shtetasit V. Ç me nr. *** prot., datë 15.2.2019 ndaj trupit gjykues, ku subjekti i rivlerësimit është anëtar. Denoncimi ka në objekt shkelje ligjore, të cilat janë formalizuar në një kallëzim penal ndaj trupit gjykues, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, bashkëlidhur këtij denoncimi. Edhe pse ky denoncim nuk përmban elementet e detyrueshme që lidhen me përshkrimin e shkeljes ligjore, fakteve, pasojave ligjore sipas pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, administroi faktet e përmendura në kallëzim, që lidheshin kryesisht me pakënaqësitë ndaj vendimit të marrë nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me anëtarët e tjerë të trupit. Sipas denoncuesit çështja është ankimuar në një gjykatë me të lartë.

68.3 Denoncim i shtetasit V. Ç me nr. *** prot., datë 15.3.2019 denoncim i përsëritur.

Komisioni, pasi administroi faktet, bazuar në germën “e”, të pikës 2, të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se: *“Vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim”*, vlerëson se nuk mund të marri në shqyrtim çështje që janë në kompetencë të një institucioni kompetent që është gjykata më e lartë.

68.4 Denoncim i shtetasit Sh.B.H me nr. *** prot., datë 30.7.2018, i drejtuar ndaj 5 gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, ndërmyet të cilëve është edhe subjekti i rivlerësimit. Ky denoncim është i paqartë dhe nuk përmban elementet e domosdoshme që lidhen me objektin e tij, përshkrimin e shkeljes ligjore dhe pasojat e ardhura sipas pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet nga Komisioni.

68.5 Denoncim i shtetasit A. H me nr. *** prot., datë 6.11.2018, drejtuar ndaj gjashtë subjekteve. Në këtë denoncim, përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, e cila është denoncuar se ka dhënë vendim të padrejtë së bashku me anëtarët e tjerë të trupit (trup i caktuar me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 25, datë 24.3.2017) në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për çështjen penale nr. ***** Akti, me kërkesë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Përmet, me të pandehur K. S akuzuar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

Komisioni i vlerësoi faktet e trajtuara si *indicie* të mëtejshme dhe i kërkoi³⁰ gjykatës kompetente dosjen gjyqësore.

68.5.1 Lidhur me këtë denoncim, Komisioni vlerësoi të kërkojë shpjegimet e subjektit për këtë çështje, i cili është shprehur se është ushtruar ankim dhe kjo çështje është në gjykatë të lartë, duke sjellë edhe dokumentacionin që lidhet me këtë dosje, si dhe vërtetimin nga gjykata. Subjekti është shprehur se ka zbatuar drejt ligjin lidhur më këtë çështje.

68.6 Denoncim i shtetasit A. H me nr. *** prot., datë 23.1.2019, drejtuar ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, ndër këto edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni (kryesuese e trupit të apelit për

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 12.12.2019, shkresë nr. *** datë 18.12.2019 dhe kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.12.2019 dhe kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.12.2019.

Krimet e Rënda), të cilët i ka denoncuar për marrje të vendimeve të padrejta në dënimin e tij për veprën penale “trafikim i narkotikëve”.

68.6.1 Komisioni, pasi administroi faktet, vlerëson se nuk ka kompetencë të shqyrtojë mbi vendimet e dhëna nga një gjykatë, të cilat shqyrtohen dhe vlerësohen nga një gjykatë tjetër më e lartë.

68.7 Denoncim i shtetasës D. K me nr. *** prot., datë 6.3.2018, e cila ka denoncuar disa subjekte të rivlerësimit (më shumë se 40 subjekte), ndër to edhe subjektin e rivlerësimit për vendime të padrejta, të cilat sipas denoncuesit janë marrë në favorizim të palës kundërshtare. Subjekti nuk ka bashkëlidhur asnjë akt (vendim gjykate) ku të bazojë ankesën e saj. Komisioni administroi faktet e parashtruara në denoncim lidhur me marrjen e vendimeve të padrejta nga subjekti i rivlerësimit dhe mban qëndrimin se faktet nuk përmbajnë *indicie* në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe se Komisioni nuk ndërhyr në vlerësimin e ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve gjyqësore të marra nga subjekti të cilat kontrollohen nga një gjykatë e lartë.

68.8. Denoncim i shtetasve E.Sh, G.D, E. Z, B.Sh me nr. *** prot., datë 30.9.2019 ndaj subjektit të rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarës së vetme që ka gjykuar kërkesën e tyre për përjashtimin e gjyqtarit A.V nga gjykimi i çështjes gjyqësore që po zhvillohet ndaj tyre. Denoncuesit në këtë ankim, ndër të tjera, ankohen për shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit lidhur me shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e këtij gjyqtari, shkelje këto që lidhen me mosrespektimin prej saj të kërkesës së pikës 1/1, të nenit 21, të Kodit të Procedurës Penale për marrjen e mendimit me shkrim të gjyqtarit ndaj të cilit po shqyrtohet kërkesa për përjashtim. Gjithashtu, denoncuesit ankohen se subjekti ka mbajtur standard të ndryshëm në shqyrtimin e çështjeve të njëjta.

68.8.1 Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka administruar kërkesën e denoncuesit për përjashtim të gjyqtarit A.V në përputhje me nenin 21 të Kodit të Procedurës Penale, ka administruar mendimin me shkrim të gjyqtarit, ka vlerësuar shkaqet e kërkesës së denoncuesve, ka disponuar me vendim mospranimi të kërkesës për përjashtim të këtij gjyqtari duke e arsyetuar vendimin. Lidhur me mbajtjen e dy standardeve në gjykimin e kërkesave të njëjta nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se për sa denoncuesi nuk e ka të bazuar këtë pretendim në dokumentacion, bëhet i pamundur analizimi i këtij pretendimi.

68.9 Denoncim i shtetasit S.S me nr. *** prot., datë 14.5.2019, i cili ka denoncuar subjektin e rivlerësimit në cilësinë e kryesueses së trupit, si dhe dy subjekte të tjera të rivlerësimit, për lënien në fuqi të vendimit nr. **, datë 26.2.2019 për mosfillimin e procedimit penal kundër prokurores S.S, gjyqtar L.S dhe OPGJ G.F. Sipas denoncuesit, lidhur me procedimin penal nuk janë kryer as veprimet e para procedurale (regjistrimi i procedimit) dhe nuk është thirrur të sqarojë për faktet e kallëzuara.

68.9.1 Lidhur në këtë denoncim, Komisioni vlerësoi të kërkojë shpjegimet e subjektit për këtë çështje. Subjekti në shpjegimet e tij ka sqaruar se janë respektuar dispozitat penale dhe procedurale.

68.10 Denoncim i shtetasit A. V me nr. *** prot., datë 30.8.2019, i cili ka denoncuar një grup subjektesh rivlerësimi, prokurorë, anëtarë të trupit të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe të Apelit të Krimeve të Rënda për dhënie dënimi të padrejtë, ku subjekti i rivlerësimit sipas denoncuesit ka qenë anëtare trupi në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda. Denoncuesi ankohet për këto subjekte për vendime të padrejta, sipas të cilave është dënuar padrejtësisht për veprat penale “trafikim të femrave për shfrytëzim prostitucioni” dhe “falsifikim dokumentacioni” kryer në bashkëpunim me persona të tjerë. Sipas denoncuesit Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda nuk e ka nënshkruar vendimin e dënimit të këtij shtetasi, por vetëm ka shënuar emrat e trupit me inicialet D. V. Gjithashtu, denoncuesi ka kërkuar t’i kthehet pafajësia, çështja të rikthehet për shqyrtim në themel, si dhe të kthehen sendet e sekuestruara me vendim. Lidhur me këto kërkesa, denoncuesi

është shprehur se ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Denoncuesi nuk i ka paraqitur Komisionit dokumentacionin, ku mbështet denoncimin.

68.10.1 Lidhur me kërkimet e subjektit, Komisioni vlerëson se janë të natyrës së themelit që i takojnë një gjykatë tjetër më të lartë, e cila kontrollon vendimet e marra nga një gjykatë tjetër më e ulët, e në rastin konkret do të jetë gjykatë e lartë, gjykatë kompetente që do të shqyrtojë pretendimet e denoncuesit. Për këto arsye, faktet e trajtuara në këtë denoncim nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

68.11 Denoncim i shtetasit R.Sh.K me nr. ****, datë 26.6.2019, i drejtuar ndaj disa subjekteve të rivlerësimit përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, të cilët janë denoncuar për korrupsion në marrjen e vendimit lidhur me dënimin padrejtësisht të djalit të tij E. K. Konkretisht, për subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e relatores së çështjes, denoncuesi është ankuar për gjykim të njëanshëm pasi ka lidhje të forta miqësore me hasmin dhe kryen seancat gjyqësore me dyer të mbyllura, duke mos pranuar asnjë pjesëtar të familjes në këto seanca. Ky denoncues ka paraqitur edhe denoncime të tjera që lidhen me çështjen penale në ngarkim të djalit të tij E. K, si më poshtë vijon:

68.11.1 Denoncim nr. *** prot., datë 25.6.2019 i drejtuar ndaj subjektit të rivlerësimit (në cilësinë e kryesueses së trupit në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda), ku denoncohen fakte që lidhen me zvarritjen e gjykimit (që nga nëntori i vitit 2017 e deri më 24.6.2019) për gjykimin e çështjes ndaj djalit të tij E.K jashtë çdo afati (dy vite) dhe, për pasojë, duke e lënë në paraburgim padrejtësisht, për shqyrtimin e çështjes me dyer të mbyllura në kundërshtim me dispozitat procedurale dhe duke e paragykuar çështjen. Denoncuesi ka bashkëlidhur dokumentacion, ku mbështet faktet e tij.

68.11.2 Vazhdim denoncimi me nr. *** dhe *** datë 3.7.2019, paraqitur nga shtetasi R. K, nëpërmjet të cilit janë paraqitur provat si: kërkesë për gjykimin e procedimit penal ndaj shtetasit E. K akuzuar për veprën penale “vrasje për gjakmarrje” mbetur në tentativë ndaj shtetasit G. D; “plagosje e rëndë me dashje” ndaj shtetasit L.D; “mbajtje pa leje e armëve të ftohta” parashikuar nga nenet 78/a -22,88/1, 278/1, 279/2 të Kodit Penal, si dhe ndaj shtetasit E. C akuzuar për veprën penale “moskallëzim krimi”; shkresë drejtuar ambasadorit amerikan në Shqipëri; shkresë me nr. *** prot., datë 11.1.2017, lëshuar nga Prokuroria e Përgjithshme; kërkesë për përjashtim gjyqtari; ankim datë 15.3.2018 kundër vendimit nr. ***, datë 8.11.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda; vendim nr. **, datë 10.4.2017, të Gjykatës së Apelit Për Krimet e Rënda, që ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë për rrëzimin e kërkesës së kërkuarit K me objekt deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit personal “arrest në burg”; mbrojtje ligjore datë 15.12.2018 për të pandehurin K; si dhe aktekspertim datë 17.8.2016.

68.11.3 Komisioni vlerësoi faktet e paraqitura, lidhur me faktet e trajtuara në këtë denoncim, dhe pretendimit e denoncuesit për shqyrtimin e kësaj çështjeje me dyer të mbyllura.

68.11.4 Duke vlerësuar sa më lart, mbi sa është trajtuar në këtë denoncim, Komisioni kërkoi shpjegimet e subjektit lidhur me këtë çështje dhe shkaqet ku është bazuar shqyrtimi i çështjes me dyer të mbyllura.

68.11.5 Lidhur me këtë çështje, subjekti ka argumentuar se për shkak të rrezikshmërisë së personit, gjykimi është zhvilluar me dyer të mbyllura, bazuar në udhëzimet e paraburgimit dhe duke depozituar edhe prova e dokumentacion shkresor nga institucionet shtetërore për të mbështetur shpjegimet e saj.

68.12 Komisioni, pasi analizoi denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte konkrete lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit, dhe nuk gjeti *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarës.

68.13 Komisioni vlerëson se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka kompetencë të gjykojë mbi korrektësinë e vendimeve dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Konkluzion për vlerësimin e aftësisë profesionale

68.14 Trupi gjykues, bazuar në konstatimet e mësipërme, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pas një analize në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, ka arritur nivel kualifikues.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Nure Dreni:

- a. nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Nure Dreni, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 17.6.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Xhensila PINE
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha